

Support to Civil Society Dialogue - "People to People Actions"

Avancimi i Pjesëmarrjes dhe Përfaqësimit të Grupeve të Pakicave Etnike në Arsim

Hulumtimi kombëtar

Kosovë

Qendra për Arsim e Kosovës



Ky projekt financohet nga:

Bashkimi Evropian & Instituti për Shoqëri të Hapur



Qendra për Arsim e Kosovës

Avancimi i pjesëmarrjes dhe përfaqësimit të grupeve të pakicave etnike në arsim

Raporti Kombëtar, Kosovë

Autor:

Shkelzen Gashi

Kontakti:

Jehona Xhaferi

Qendra për Arsim e Kosovës

Kompleksi i Shkollës "Mileniumi i Tretë"

rr. "Isa Kastrati", p.n. 10000 Prishtinë, Kosovë

Tel: +381 38 244 257, 258 203;

Fax: +381 38 244 257 ext. 109

E-mail: office@kec-ks.org

Web: www.kec-ks.org

Janar 2010

This project is implemented jointly by Open Society Foundation for Albania, proMENTE Social Research – Bosnia and Herzegovina, Network of Education Policy Centers (NEPC) - Croatia, Kosova Education Center (KEC) - Kosovo, Center for Education 2000 + (CEDU) - Romania and Group Most - Serbia. The views expressed in this publication do not necessarily reflect the views of the European Union and Open Society Institute



Funded by:

European Commission



OPEN SOCIETY INSTITUTE
& Soros Foundations Network

1. Desk Research

Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, i hartuar nga i Dërguari i Posaçëm i Sekretarit të Përgjithshëm të OKB-së për Statusin e Ardhshëm të Kosovës, Presidenti Martti Ahtisaari, në ankesin 2, Të Drejtat e Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të Tyre, neni 3, thotë që pjesëtarët e komuniteteve kanë të drejtë, në mënyrë individuale apo si komunitet që, veç tjerash, të pranojnë arsimim publik parashkollor, primar dhe sekondar në gjuhën e tyre, ku pragu për themelimin e paraleleve apo shkollave të veçanta për këtë qëllim është më i ulët se ai që zakonisht parashihet për institucionet arsimore. Krejtësisht të njëjtën gjë e thotë edhe Kushtetuta e Republikës së Kosovës dhe Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, por edhe Rregullorja 2002/19 lidhur me shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës.

Propozimi i Martti Ahtisaarit është pjesë e Deklaratës së Pavarësisë së Kosovës, të shpallur më 17 shkurt 2008, por edhe Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të aprovuar më 15 qershor 2008. Për më shumë, sipas nenit 143 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, në rast se ka papajtueshmëri mes Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Propozimit Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, ky i fundit mbizotëron.

Sipas ligjit për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, në komunat ku ka një numër të pamjaftueshëm nxënësish për të vënë në dispozicion shkollimin në një gjuhë jo-zyrtare të komunitetit, Qeveria e Republikës së Kosovës ka për detyrë të ofrojë alternativa, duke përfshirë transportin e subvencionuar deri në zonat ku ofrohet shkollim i tillë, pastaj shkollimin në distancë, aranzhimet e ndryshme për mësimdhënie të lëvizshme, apo edhe ofertat për qëndrim në konvikt. Institucionet shkollore në Kosovë që veprimtarinë e tyre e zhvillojnë në gjuhën e një komuniteti që nuk është gjuhë zyrtare, mund t’i dizajnojnë plan-programet shkollore të tyre në mënyrën e tyre, me kusht që ato të jenë në përputhje me kornizën e përgjithshme të plan-programit të integruar dhe që t’i përmbushin standardet e arritjes që përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Për më shumë, komunitetet kanë të drejtë që në bashkëpunim me Qeverinë, të përgatisin module shkollore që kanë të bëjnë me kulturën, historinë dhe traditat e tyre.

Qeveria e Republikës së Kosovës, sipas ligjit të sipërpërmendur, duhet të sigurojë kuadër të mjaftueshëm për trajnimin e mësuesve, e për ata që duhet të japin mësim në gjuhët e komuniteteve trajnimet duhet të zhvillohen në gjuhët përkatëse. Gjatë përzgjedhjes së kandidatëve të përshtatshëm, autoritetet duhet të kenë parasysh nevojën që mësimdhënia në gjuhët e komuniteteve të ofrohet nga folësit e kualifikuar të gjuhës së dhënë, ku parapëlqehen folësit burimor. Ligji për Mbrojtjen dhe



Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës thotë se Qeveria e Republikës së Kosovës duhet të sigurojë që drejtuesit dhe mësuesit e institucioneve të shkollimit publik ta zhvillojnë aktivitetin e tyre në gjuhët e komuniteteve dhe të jenë kryesisht përfaqësues të këtyre komuniteteve dhe ta njohin në tërësi identitetin e komunitetit përkatës. Po ashtu, sipas ligjit, organizatat përfaqësuese të komuniteteve duhet të konsultohen gjatë hartimit të plan-programit shkollor kombëtar të Kosovës, i cili duhet të mbulojë historinë, kulturën dhe atributet e tjera të komuniteteve tradicionalisht të pranishme në vend, me qëllim që të nxis frymën e respektit, mirëkuptimit dhe tolerancës midis të gjitha komuniteteve në Kosovë.

Sipas ligjit për Arsim në Komunitat e Republikës së Kosovës, Ministria e Arsimit ka përgjegjësi që të promovojë një sistem arsimor jo-diskriminues në të cilin respektohet e drejta e secilit person për arsim, por edhe të promovojë pjesëmarrjen e prindërve dhe komunitetit në aktivitetet arsimore dhe format e dhura të partneriteteve shkollë-komunitet në nivel lokal. Po ashtu, rregullorja 2002/19 lidhur me shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë, e miratuar nga Kuvendi i Kosovës, parasheh të krijohet Komiteti i Prindërve i Arsimit të Kosovës (KPAK), i përbërë nga nëntë anëtarë me mandat 4 vjeçar, për të përfaqësuar interes të prindërve, për t'ia përcjellë Ministrisë së Arsimit mendimet e prindërve për çdo aspekt të arsimit fillor dhe të mesëm në Kosovë dhe për të qenë kanal kryesor i komunikimit midis Ministrisë së Arsimit dhe prindërve.

Duhet thënë se procedurën e zgjedhjes dhe përgjegjësitë e organeve qeverisëse, profesionale dhe personelit tjetër të shkollave fillore dhe të mesme në territorin e Kosovës i përcakton Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, i miratuar më 28 janar 2003. Në bazë të këtij udhëzimi, organet qeverisëse në shkollë janë: Drejtori i Shkollës; Këshilli i Shkollës dhe Këshilli i Nxënësve, kurse organet profesionale në shkollë janë: Këshilli i Arsimtarëve; Këshilli i Klasave dhe Aktivitet Profesional, ndërsa personeli tjetër i shkollës janë: Personeli Mësimdhënës, Bashkëpunëtorët Profesionalë, Personeli Administrativ dhe Personeli Teknik.

Sipas udhëzimit të sipërpërmendur, çdo shkollë në Kosovë duhet të formojë Këshillin e Shkollës, i cili zgjedhet nga mësimdhënësit e shkollës dhe përfaqësuesit e prindërve. Në Këshillin e Shkollës mësimdhënësit kanë të drejtë të zgjedhin pesë përfaqësues, kurse prindërit kanë të drejtë të zgjedhin tre përfaqësues, ndërsa Këshilli i Nxënësve të Shkollës ka të drejtë të zgjedhë një përfaqësues nga radhët e nxënësve. Zgjedhja e anëtarëve të Këshillit të Shkollës bëhet në mënyrë të fshehtë dhe mandati i tyre është tre vjet, me mundësi rizgjedhjeje me kusht që ata vazhdojnë të jenë prindër të nxënësve, mësues ose nxënës të shkollës.

Kryetari i Këshillit të Shkollës zgjedhet çdo vit me vota të fshehta dhe duhet të jetë nga radhët e prindërve, kurse Sekretar i Këshillit të Shkollës është Drejtori i Shkollës, i cili nuk ka të drejtë vote. Këshilli i Shkollës ka përgjegjësi: për hartimin e rregullave të shkollës, të cilat i paraqiten për miratim komunës; për të zgjedhë një përfaqësues të

prindërve dhe një përfaqësues të profesorëve për të marrë pjesë në zgjedhjen e drejtorit të shkollës dhe profesorëve; për të vendosë për caktimin e fondeve me kontribut nga prindërit dhe fondet tjera të siguruara jashtë buxhetit të shkollës; për veprimtaritë jashtë shkollore; për mbajtjen e dokumentacionit për të gjitha mjetet financiare të shkollës. Këshilli i Shkollës konsultohet për çështjet e zhvillimit fizik të shkollës, çështjet e programit shtesë mësimor (por jo për programin mësimor sepse kjo është kompetencë e Ministrisë së Arsimit), datat e pushimeve të shkollës dhe përgjithësisht shprehjen e pikëpamjeve të tyre lidhur me shkollën.

Sidoqoftë, meqenëse në Kosovë nuk është bërë regjistrimi i popullsisë që nga viti 1981, nuk dihet saktë numri i qytetarëve dhe përbërja e tyre etnike, prandaj llogaritet se afërisht 90% e qytetarëve janë të përkatësisë kombëtare shqiptare, kurse përqindjen tjetër e përbëjnë minoritetet: ashkalinjtë, boshnjakët, egjiptasit, romët, sërbët, turqit, goranët... Minoriteti më i madh, jo vetëm numerikisht, por edhe politikisht, është minoriteti sërb, i cili sipas propozimit të hartuar nga Martti Ahtisaari, përkatësisht aneksit 3, decentralizimi, nenit 7, që ka të bëjë ekskluzivisht me arsimin, për sa i përket planprogrameve arsimore të shkollave të Kosovës që ofrojnë mësim në gjuhën serbe, ka të drejtë të zbatojë planprograme apo tekste shkollore të hartuara nga Ministria e Arsimit e Republikës së Serbisë, me njoftim të Ministrisë së Arsimit të Kosovës, e në rast se Ministria e Arsimit e Kosovës kundërshton përdorimin e planprogramit apo tekstit shkollor të veçantë, çështja i referohet një komisioni të pavarur për të shqyrtuar pajtueshmërinë e planprogramit apo tekstit shkollor në fjalë me Kushtetutën e Kosovës dhe legjislacionin e miratuar në pajtim me këtë zgjidhje.

Megjithëkëtë, duke e pasë parasysh se minoriteti sërb nuk e ka pranuar Propozimin e hartuar nga Martti Ahtisaari, e as Kushtetutën e Republikës së Kosovës, e posaçërisht duke e pasë parasysh se nxënësit sërbë në Kosovë janë shumicë absolute në shkollat e organizuara nga strukturat paralele të mbështetura nga Republika e Sërbisë, ky raport paraqet gjendjen e pjesëmarrjes së minoriteteve etnike (pa sërbët) në procesin e edukimit në Kosovë.

Në hartimin e këtij raporti përveç ‘desk research’ është bërë edhe ‘qualitative research’ me profesorët e shkollave të mesme, drejtoritë e shkollave të mesme, prindërit e nxënësve minoritarë të shkollave të mesme dhe me nxënësit e shkollave të mesme. Hulumtimi është bërë në pesë qytete të Kosovës:

- në Prishtinë në gjimnazin “Sami Frashëri”, ku ka minoritet turk, janë intervistuar drejtori dhe zëvendës drejtori, katër profesorë, katër nxënës dhe katër prindër;
- në Prizren në gjimnazin “Gjon Buzuku”, ku ka minoritet turk dhe boshnjak, janë intervistuar drejtori dhe zëvendës drejtori, tetë profesorë, tetë nxënës dhe katër prindër;
- në Pejë në shkollën e mesme ekonomike “Ali Hadri”, ku ka minoritet boshnjak, janë intervistuar drejtori, katër profesorë, gjashtë nxënës dhe katër prindër;

- në Gjilan në gjimnazin “Zenel Hajdini”, ku ka minoritet turk, janë intervistuar drejtori dhe zëvendës drejtori, katër profesorë, katër nxënës dhe katër prindër;
- në Fushë Kosovë në gjimnazin “Hivzi Sylejmani”, ku ka minoritet ashkali, janë intervistuar drejtori, katër profesorë, tre nxënës dhe dy prindër;

2. Qualitative Research

2.1. Gjimnazi “Sami Frashëri” - Prishtinë

Gjimnazi “Sami Frashëri” në Prishtinë është themeluar si gjimnaz turk para vitit 1913, por nuk dihet viti i saktë. Prej vitit 1913 deri në vitin 1941 mësimi në këtë gjimnaz është zhvilluar në gjuhën serbe, kurse në vitet 1941-1945 mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe në këtë kohë ky gjimnaz ka marrë emrin “Sami Frashëri”. Prej vitit 1945-1955 mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe dhe serbe dhe është quajtur *gjimnazi real shqiptar* dhe *gjimnazi real serb*. Prej vitit 1955-1989, mësimi është zhvilluar po ashtu në gjuhën shqipe dhe serbe dhe gjimnazi është quajtur “Ivo Lola Ribar”. Prej vitit 1990, kur pushteti serb ka dëbuar shqiptarët nga objektet shkollore, në këtë gjimnaz mësimi është zhvilluar në objekte (shtëpi) private dhe këtij gjimnazi i është rikthyer emri “Sami Frashëri”. Prej përfundimit të luftës në Kosovë, 12 qershor 1999, ky gjimnaz zhvillon procesin mësimor në objektin e vet. Aktualisht, ky gjimnaz ka 2315 nxënës, prej të cilëve 109 janë të minoritetit turk, të tjerët shqiptarë dhe ka 80 profesorë, prej të cilëve 10 janë të minoritetit turk, të tjerët shqiptarë.

Studimi i idesë së pjesëmarrjes dhe angazhimit në mësim/ Strategjia e shkollës për të mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e prindërve/nxënësve/ Motivimi i prindërve/nxënësve/ Pengesat dhe barrierat për pjesëmarrje dhe angazhim/ Përgatitje të veçanta për nxënësit minoritarë

Drejtorja e gjimnazit “Sami Frashëri” thotë se nuk ka asnjë aktivitet/program/iniciativë për rritjen e pjesëmarrjes së prindërve/nxënësve në shkollë. I vetmi projekt i përbashkët mes prindërve/nxënësve dhe drejtorisë së shkollës është për ndërtimin e një objekti shtesë meqë kërkesat për t’u regjistruar në këtë shkollë janë shumë të mëdha. Sipas drejtorisë së këtij gjimnazi, nuk ka ndonjë projekt as nga ana e Ministrisë së Arsimit për me rritë pjesëmarrjen e prindërve/nxënësve në shkollë. Në nivelin shkollor nuk mund të mirren vendime të rëndësishme për edukimin sepse drejtorja e shkollës mund të bëjë vetëm organizimin përkatësisht menaxhimin e shkollës. Sipas drejtorisë, nxënësit dhe prindërit kanë fuqi reale vendim-marrëse në shkollë meqë organi më i lartë në shkollë, Këshilli i Shkollës, pa pëlqimin e të cilit nuk mund të merret asnjë vendim, është i përbërë përveçse nga pesë profesorë, edhe nga dy prindër dhe një nxënës. Ky këshill kryesohet nga përfaqësuesit e prindërve dhe menaxhon mjetet që i ndahen nga grante të ndryshme dhe i jep llogari Drejtorisë Komunale të Arsimit.

Drejtorja e Shkollës pohon se është e interesuar për angazhimin e prindërve në jetën shkollore sepse pa angazhimin e prindërve mbarëvajtja e procesit mësimor, që



nënkupton vijimin e rregullt të procesit mësimor, por edhe suksesin në mësim, vihet në dyshim. Sipas drejtorisë prindërit angazhohen në jetën shkollore edhe duke ndihmuar në zgjidhjen e konflikteve eventuale që mund të ndodhin në shkollë, por, mbi të gjitha, duke kontribuar në menaxhimin e shkollës dhe, duhet thënë se, iniciativat në këtë drejtim pothuajse gjithmonë vijnë nga prindërit/nxënësit. Për ta ilustruar këtë, drejtorja ofron shembullin në vijim:

Meqenëse gjimnazi “Sami Frashëri” nuk furnizohet pa ndërprerje me ujë nga rrjeti i ujësjellësit, prindërit/nxënësit kanë ndërmarrë iniciativë për ta ble një rezervar për ujë, në mënyrë që në shkollë të ketë ujë edhe kur nuk ka ujë nga rrjeti i ujësjellësit. Po ashtu, duke pasqyruar vështirësitë e furnizimit me rrymë, prindërit/nxënësit kanë ndërmarrë iniciativë për grumbullimin e të hollave për ta ble një gjenerator, mirëpo, fatmirësisht, në fund ka ndërhy Drejtoria për Arsim e Komunës së Prishtinës dhe i ka nda mjetet për gjenerator. Duhet thënë se ka raste edhe kur nxënës të klasëve të caktuara, me pëlqimin e prindërve të tyre, mbledhin mjete financiare për t’i gëllqerosë klasët e tyre.

Sikundër u tha më sipër, Këshilli i Shkollës është organi më i lartë dhe vendimet në këtë këshill, i cili përbëhet nga pesë profesorë, dy prindër e një nxënës, merren me shumicë votash. Pra, duket qartë se prindërit/nxënësit mund të mbivotohen, por kjo, sipas drejtorisë së gjimnazit “Sami Frashëri”, nuk ka ngjarë asnjëherë deri më tani. Përkritazi më përzgjedhjen e prindërve në Këshillin e Shkollës, secila klasë zgjedhë vetë nga dy prindër përfaqësues, të cilët më pas zgjedhin Këshillin e Prindërve të Shkollës, i cili përbëhet nga 11 prindër dhe më pas Këshilli i Prindërve dërgon përfaqësuesit e vet në Këshillin e Shkollës. Për zgjedhjen e prindërve përfaqësues nuk parashihet ndonjë njohuri apo përvojë, por kryesisht merret parasysh vullneti për aktivitetet.

Sipas drejtorisë, prindërit janë të interesuar të marrin pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë sepse janë në pyetje fëmijët e tyre, por ka raste edhe kur nuk janë të interesuar për të marrë pjesë në marrjen e këtyre vendimeve, mirëpo rastet e tilla nuk janë të shpeshta. Për më shumë, prindërit angazhohen edhe në aktivitetet jashtëprogramore si ekskursionet brenda, por edhe jashtë vendit. Drejtoria e gjimnazit pranon se shkolla nuk ka ndonjë strategji të veçantë për të inkurajuar pjesëmarrjen e prindërve në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre.

Në lidhje me të drejtat e grupeve minoritare, drejtoria nuk i informon prindërit/nxënësit e grupeve minoritare për të drejtat që u takojnë atyre, qoftë përmes shpërndarjes së materialeve të shkruara apo përmes organizimit të takimeve të veçanta me nxënësit minoritarë. Drejtoria thotë se kur shkolla ka aktivitetet kulturore, si për shembull, dita e shkollës, minoritarët zakonisht ftohen për të marrë pjesë në aktivitetet që organizon shkolla. Për më shumë, sipas drejtorisë, nxënësit minoritarë nuk kanë kurrfarë barrierash gjuhësore për të komunikuar me autoritetet shkollore meqë ata komunikojnë lirshëm në gjuhën shqipe. Drejtoria thotë se jo vetëm që nuk ka mosmarrëveshje mes profesorëve në shkollë dhe nxënësve që u takojnë grupeve minoritare etnike, por as mes nxënësve që u takojnë grupeve minoritare etnike dhe personelit të shkollës.

**Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Komunikimi shtëpi-shkollë/
Komunikimi me Prindërit e Nxënësve Minoritarë/ Mbështetja e profesorëve për
përmirësimin e pjesëmarrjes së prindërve**

Profesorët e gjimnazit “Sami Frashëri” thonë se angazhimi i prindërve është i ulët edhe pse gati gjysma e prindërve vijnë në mbledhje të prindërve, por nuk janë aktiv e të interesuar sa duhet – ndonëse më shumë se gjysma e prindërve janë të shkolluar – për shkak të gjendjes së rëndë ekonomike. Sipas tyre, prindërit, përveç pjesëmarrjes në mbledhje të prindërve (pjesëmarrja nuk është shumë e kënaqshme) dhe angazhimit në organizimin e ekskursioneve, nuk mund të kontribuojnë në vendimet për programin mësimor sepse për këtë vendos vetëm Ministria e Arsimit.

Profesorët janë të mendimit se sikur prindërit të angazhoheshin dhe të vinin çdo javë në shkollë do të ndikonin pozitivisht sepse nxënësit do të mësonin më shumë, por edhe do të vijonin mësimin më me rregull. Ata thonë se takimet me prindërit organizohen sy më sy katër herë brenda një viti dhe ato janë obligative, por, përveç takimeve obligative, një orë në javë është e ndarë për prindërit që janë të interesuar për suksesin e fëmijëve të tyre. Profesorët kontaktojnë me prindërit edhe përmes telefonit dhe shkojnë në shtëpitë e tyre, por vetëm në raste kur prindërit nuk vijnë për t’u interesuar për fëmijët e tyre, ndërsa gjendja e tyre në shkollë është e keqe (kanë nota të dobëta; nuk e vijnë me rregull mësimin; bëjnë probleme...).

Profesorët pohojnë se asnjë grup i prindërve nuk është i përjashtuar nga jeta shkollore, e as prindërit e grupeve minoritare, të cilët, sipas profesorëve, nuk kanë barriera gjuhësore për t’u angazhuar sepse që të gjithë e flasin edhe gjuhën shqipe. Ata e pranojnë se shkolla nuk ka ndihmuar për angazhim më të madh të prindërve të nxënësve minoritarë sepse mosangazhimi adekuat i prindërve është pasojë e gjendjes së rëndë ekonomike, e jo për ndonjë arsyeje tjetër. Për sa i përket angazhimit të prindërve në procesin e edukimit, profesorët thonë se nuk kanë pasë ndonjë trajnim, përveç trajnimeve për procesin e reformave, të organizuara nga Ministria e Arsimit, Drejtoria për Arsim e Komunës, Qendra për Arsim e Kosovës...

**Definimi i pjesëmarrjes së nxënësve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e
nxënësve minoritarë/ Komunikimi fëmijë-shkollë**

Nxënësit minoritarë të gjimnazit “Sami Frashëri” thonë se kanë ndikim në shkollë (edhe pse vendimet merren nga shumica) sepse asnjëherë nuk ka pasë raste kur vendimi që e ka marrë shumica nuk ka qenë i pranueshëm edhe për ta. Fushat ku ata mund të angazhohen suksesshëm në procesin mësimor janë ndjekja e rregullt e procesit mësimor dhe kryerja me sukses e detyrave që marrim nga profesorët, por edhe angazhimi në aktivitete jashtë programit mësimor, si aktivitete sportive, humanitare, ekskursione jashtë, po edhe brenda vendit, vizita në muze... mirëpo, nuk mund të ndikojnë në programin mësimor dhe në mënyrën e zhvillimit të procesit mësimor. Ata marrin pjesë në aktivitetet e organizuara për ditën e shkollës, por kërkojnë që këtë ditë të ketë aktivitete edhe në gjuhën turke.

Shkolla nuk u ka ofruar nxënësve minoritarë ndonjë mundësi për t’u ndihmuar që të kuptojnë nevojat e tyre mësimore, por as nuk ka përdorë ndonjë strategji për ta nxitë pjesëmarrjen e tyre në procesin e edukimit. Për më shumë, shkolla nuk i ka informuar asnjëherë nxënësit e minoriteteve etnike për të drejtat që u takojnë atyre si minoritete. Ata thonë se 23 prill është dita e tyre dhe këtë ditë nuk mbahet mësim: organizohen aktivitete sportive, kulturore, teatrale, letrare..., mirëpo jo në shkollë, por në ndërtesën e bashkësisë lokale turke në Prishtinë...

Nxënësit kërkojnë që lajmërimet që sjellë drejtorja e shkollës të mos jenë vetëm në gjuhën shqipe, por edhe në gjuhën turke sepse ka nxënës që nuk e kuptojnë tërësisht përmbajtjen e lajmërimeve. Po ashtu, duke e pasë parasysh se një pjesë e nxënësve nuk e kuptojnë gjuhën shqipe, shkolla nuk ka bërë asgjë për ta, në mënyrë që të mos kenë probleme për të komunikuar me drejtorinë e shkollës. Në vijim të kësaj, nxënësit e minoritetit turk kërkojnë të mësojnë në shkollë lëndën e gjuhës shqipe më shumë se dy herë në javë sepse, sipas tyre, kjo nuk është e mjaftueshme. Gjithashtu, ata janë të mendimit se lëndët gjuhë angleze dhe gjuhë latine, të cilat ua japin profesorë shqiptarë, në të ardhmen do të duhej t’ua japin profesorë të komunitetit turk. Sipas tyre dy janë barrierat kryesore për angazhim e tyre më aktiv në procesin e edukimit të tyre:

Problemi i parë është mungesa e teksteve mësimore. Profesorët diktojnë. Kemi tekst mësimor vetëm për gjuhën dhe letërsinë turke, të cilin e kemi marrë nga Turqia, e cila na ka dërguar tekste pa pagesë edhe për lëndët tjera, por ato nuk mund t’i shfrytëzojmë meqë nuk janë në përputhje me planprogramin e Kosovës. Problemi i dytë është se ne kemi tri klasë me nxënës të minoritetit turk dhe në këto klasë janë regjistruar edhe nxënës shqiptarë për të paktën tri arsye: nuk kanë mundur të regjistrohen në drejtimin shqip të gjimnazit “Sami Frashëri”; për të shkuar më lehtë në Turqi për studime; për t’u regjistruar me lehtë në fakultetet e Universitetit të Prishtinës meqë ka lehtësira për minoritetet...¹

Për sa i përket komunikimit mes nxënësve dhe shkollës, nxënësit e minoritetit turk thonë se shkolla i trajton njësoj të gjithë nxënësit, por megjithatë nxënësit shqiptarë kanë komunikim më të shpeshtë dhe më të mirë me autoritetet e shkollës për shkak të mospasjes së barrierave gjuhësore. Prandaj, edhe pse se ata nuk kanë asnjë problem me udhëheqësinë e shkollës, kërkojnë që një zëvendës-drejtor të jetë i komunitetit turk, në mënyrë që komunikimi të jetë edhe më i lehtë.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e prindërve të studentëve minoritarë/ Komunikimi shkollë-shtëpi/ Strategjitë dhe barrierat për angazhimin e prindërve

Për prindërit e nxënësve të gjimnazit “Sami Frashëri”, angazhimi në shkollë nënkupton interesimin e prindërve për të pa nëse fëmijët e ndjekin me rregull procesin

¹ Në gjimnazin “Sami Frashëri” janë 3 paralele me nxënës të minoritetit turk me 109 nxënës, e sipas nxënësve, prej tyre 37 janë shqiptarë dhe shumica prej tyre kanë probleme për ta ndjekë mësimin në gjuhën turke, e shumë herë mësimi zhvillohet në dy gjuhë dhe kjo shkakton telashe.

mësimor, nëse mësojnë dhe nëse janë të dicitinuar dhe, sipas tyre, këtë gjë e pret edhe shkolla prej tyre. Për ta angazhimi i prindërve nuk nënkupton tjetër gjë për prindërit e nxënësve të minoriteteve etnike. Prindërit kanë ndikim në marrjen e vendimeve në shkollë sepse janë të përfaqësuar në Këshillin e Prindërve, e përfaqësuesit e Këshillit të Prindërve janë të përfaqësuar në Këshillin e Shkollës dhe ky përfaqësim është i rëndësishëm sepse bëhet fjalë për fëmijët e tyre... Prindërit e nxënësve përveç pjesëmarrjes në mbledhje, ofrimit të ndonjë ndihme simbolike financiare (kryesisht për nxënës të varfër ose të sëmurë), ndonjëherë edhe ndihmesës në çështje qeverisëse ose administrative të shkollës, nuk kanë pasë mundësi të ndihmojnë në vendimet për programet mësimore sepse një gjë e tillë nuk është e lejuar.

Prindërit e nxënësve të minoritetit turk e kujtojnë shumë mirë ditën kur i kanë regjistruar fëmijët e tyre në gjimnazin “Sami Frashëri” sepse ata, për dallim prej fëmijëve shqiptarë, janë regjistruar me procedurë më të lehtë. Drejtorja e shkollës nuk i ka informuar për të drejtat që u takojnë si prindër të fëmijëve minoritarë në asnjë mënyrë dhe, për më shumë, nuk i ka ftuar ndonjëherë për të marrë pjesë në ndonjë ngjarje kulturore të organizuar nga shkolla. Sipas tyre, problemet më të mëdha me të cilat ballafaqohen fëmijët e tyre janë:

Mungesa e teskteve mësimore, numri i madh i nxënësve në klasa, e më vonë edhe mungesa e fakulteteve në gjuhën turke në Universitetin e Prishtinës. Po ashtu, problem tjetër është se gjimnazi “Sami Frashëri” është shkolla e vetme e mesme në Komunën e Prishtinës që ofron mësim në gjuhën turke. Të gjithë janë dijeni për këto probleme, por nuk është ndërmarrë asnjëherë asgjë...

Prindërit e nxënësve të komunitetit turk thonë se nuk kanë probleme me komunikim me drejtorinë e shkollës meqë shumica dërrmuese e flasin gjuhën shqipe, por as nuk kanë mosmarrëveshje me drejtorinë e shkollës. Komunikimi i tyre me shkollën bëhet përmes mbledhjeve që mbahen katër herë në vit, por ata thonë se intersohen edhe kur nuk ka mbledhje. Ata nuk pranojnë asnjëherë raporte me shkrim nga shkolla për suksesin përkatësisht mospushtsin e fëmijëve të tyre. Shkolla nuk ka fare strategji për angazhimin e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre. Barriera kryesore e prindërve për t’u angazhuar më shumë në procesin mësimor është gjendja e rëndë ekonomike.

2.2. Gjimnazi “Gjon Buzuku” - Prizren

Gjimnazi “Gjon Buzuku” në Prizren është themeluar në vitin 1874. Mësimi në këtë gjimnaz është zhvilluar në gjuhën turke deri në vitin 1912, kurse prej vitit 1913 deri në vitin 1941, në gjuhën serbe. Prej vitit 1941 deri në vitin 1944 mësimi është zhvilluar në gjuhën shqipe, ndërsa prej vitit 1945 në gjuhën shqipe, serbe e turke dhe emri i këtij gjimnazi ka qenë “Jovanka Radivojević – Kica”. Në vitin 1991-1992 nxënësit dhe profesorët shqiptarë janë dëbuar nga objektet dhe kanë mësuar në shtëpi private. Pas luftës, 12 qershor 1999, shqiptarët janë kthyer sërish në objekte. Aktualisht shkolla ka 3100 nxënës dhe 160 profesorë, kurse hapësira e shkollës është 4941m². Shqiptarë janë 2779 nxënës e 130 profesorë; boshnjakë janë 175 nxënës e 15 profesorë; turq janë 146 nxënës e 15 profesorë. Në këtë gjimnaz janë katër drejtime:

drejtimi i përgjithshëm; drejtimi shkencat e natyrës, drejtimi matematikë-informatikë dhe drejtimi gjuhësor-shoqëror. Ky gjimnaz ka dy objekte të ndara dhe pesë punkte në fshatra.

Studimi i idesë së pjesëmarrjes dhe angazhimit në mësim/ Strategjia e shkollës për të mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e prindërve/nxënësve/ Motivimi i prindërve/nxënësve/ Pengesat dhe barrierat për pjesëmarrje dhe angazhim/ Përgatitje të veçanta për nxënësit minoritarë

Drejtorja e gjimnazit “Gjon Buzuku” thotë se ka një program për rritjen e pjesëmarrjes së prindërve/nxënësve në shkollë, i cili parasheh që të ketë takime me prindër çdo muaj, meqë aktualisht takimet mes prindërve dhe kujdestarëve të klasës mbahen katër herë në vit. Sipas drejtorisë së këtij gjimnazi, Ministria e Arsimit nuk ka ndonjë projekt për ta rritë pjesëmarrjen e prindërve/nxënësve në shkollë.

Drejtorja pohon se nxënësit dhe prindërit kanë fuqi reale vendim-marrëse në shkollë meqë organi më i lartë në shkollë, Këshilli i Shkollës, pa pëlqimin e të cilit nuk mund të merret asnjë vendim, është i përbërë përveçse nga pesë profesorë, edhe nga tre prindër dhe një nxënës. Drejtori i shkollës është edhe sekretar i Këshillit të Shkollës, por nuk ka të drejtë vote. Anëtarët e Këshillit të Shkollës nga radhët e prindërve zgjedhen nga prindërit dhe, për më shumë, Këshilli i Shkollës kryesohet nga përfaqësuesit e prindërve, ku asnjë vendim nuk mund të merret pa pëlqimin e prindërve/nxënësve, edhe pse aty ka më shumë profesorë. Këshilli i Shkollës mbledhet sipas nevojës, por rregullat kërkojnë që të mbledhet së paku katër herë në vit. Drejtorja e shkollës pohon se është e interesuar për angazhimin e prindërve në jetën shkollore dhe pret nga ta që të ndikojnë te fëmijët e tyre ta vijnë mësimin me rregull, por edhe të kenë suksese në mësim. Sipas drejtorisë:

Prindërit angazhohen në jetën shkollore duke ndihmuar në organizimet që bën shkolla për data të caktuara si: Dita e Shkollës (10 qershor), Dita e Pavarësisë së Kosovës (17 shkurt), Dita e Flamurit (28 nëntor), e kështu me radhë; pastaj për ekskursionet brenda dhe jashtë vendit, për rregullimin e oborrit të shkollës, për rregullimin e objektit të shkollës, për rregullimin e sallës së sportit, për pajisjen e bibliotekës së shkollës...

Për çdo vendim shkolla informon nxënësit përmes profesorëve, kurse prindërit informohen përmes nxënësve. Siç u tha edhe më sipër, Këshilli i Shkollës është i vetmi grup vendimmarrës, ku janë të angazhuar nxënësit, profesorët dhe prindërit, ndërsa grupet ku angazhohen vetëm profesorët dhe nxënësit janë: grupi për revistën e shkollës, grupi për letërsi, grupi për muzikë, grupi për sport... Sipas drejtorisë, prindërit janë të interesuar të marrin pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë – në këtë shkollë nuk ka pasë ndonjë projekt të inicuar vetëm nga prindërit – dhe motivi kryesor ka të bëjë kryekëput me dëshirën që fëmijët e tyre të edukohen sa më mirë. Takimet mes shkollës dhe prindërve bëhen kryesisht përmes mbledhjeve të prindërve, por ndonjëherë edhe mes drejtorisë dhe prindërve. Zakonisht prindërit e nxënësve të dalluar në mësim dhe që kanë gatishmëri për të punuar janë të interesuar për të qenë pjesë e Këshillit të Prindërve/Këshillit Shkollës dhe çdo herë në këto

organe zgjedhet dikush që është prindër i nxënësve të klasave 10/11, në mënyrë që të mund të jetë aty më gjatë.

Në lidhje me të drejtat e grupeve minoritare, drejtorja nuk i informon prindërit/nxënësit e grupeve minoritare për të drejtat që u takojnë atyre, qoftë përmes shpërndarjes së materialeve të shkruara apo përmes organizimit të takimeve të veçanta me nxënësit minoritarë. Drejtorja e gjimnazit thotë se kur shkolla ka aktivitete kulturore, si për shembull, dita e shkollës, minoritarët zakonisht ftohen për të marrë pjesë në aktivitetet që organizon shkolla, por edhe për të prezentuar diçka nga kultura e tyre. Sa i përket barrierave gjuhësore për të komunikuar me autoritetet shkollore, sipas drejtorisë, shumica e nxënësve minoritarë flasin shqip, por kur ka raste që nuk flasin shqip, atëherë, komunikimi bëhet përmes përkthyesit. Drejtorja thotë se vendimet që merr shkolla përkthehen në gjuhët e minoriteteve, e për më shumë, edhe revista e shkollës është në tri gjuhë: shqipe, turke dhe boshnjake.

Ndërkaq, përkitazi me barrierat për angazhim më aktiv të prindërve në procesin mësimor, përveç gjendjes së rëndë ekonomike, sipas drejtorisë së shkollës, pjesërisht ndikon edhe fakti se prindërve të nxënësve të dobët u vjen turp të vijnë në shkollë për t'u interesuar për fëmijët e tyre, edhe pse drejtorja e shkollës thotë se gjithnjë ka insistuar që kur flitet për sukses të dobët të ndonjë nxënësi, kjo të mos bëhet në praninë edhe të prindërve tjerë. Po ashtu, barrierë tjetër është edhe mungesa e hapësirave të veçanta për takime mes prindërve dhe kujdestarëve të klasës, në mënyrë që ata të informohen për suksesin e fëmijëve të tyre.

Drejtorja thotë se profesorët nuk komunikojnë ndryshe me nxënësit minoritarë dhe nuk mendon se nxënësit që i takojnë grupit etnik shumicë kanë komunikim më të mirë me shkollën. Sipas drejtorisë ka pasë një problem mes nxënësve të minoritetit turk dhe profesoreshës së gjuhës shqipe, e cila u ka kërkuar atyre që ta mësojnë poezinë “Himni i Flamurit” të shkrimtarit shqiptar Fan Noli, e ata kanë refuzuar të mësojnë, siç kanë thënë “poezi nacionaliste shqiptare”, por ky është rast i izoluar dhe tashmë i tejkaluar. Sipas drejtorisë, problemi më i madh që kanë nxënësit e minoriteteve etnike – përveçqë shumica e profesorëve minoritarë punojnë në disa shkolla për të plotësuar normën – është se një pjesë e mirë e profesorëve minoritarë nuk janë të kualifikuar. Po ashtu, problem është edhe mungesa e teksteve mësimore dhe për këto problem është e njoftuar Drejtorja Komonale e Arsimit, por edhe Ministria e Arsimit.

**Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Komunikimi shtëpi-shkollë/
Komunikimi me Prindërit e Nxënësve Minoritarë/ Mbështetja e profesorëve për
përmirësimin e pjesëmarrjes së prindërve**

Profesorët e gjimnazit “Gjon Buzuku” thonë se angazhimi i prindërve duhet të jetë më i madh dhe, sipas tyre, prindërit duhet të kenë më shumë kontakte me profesorët. Sipas tyre, gjendja e rëndë ekonomike po ndikon që angazhimi i prindërve të mos jetë i kënaqshëm edhe pse në fund të vitit të gjithë gjejnë kohë për të ardhë në shkollë e për të ndërhyrë në procesin e vlerësimit (përmirësimit të notave). Ata thonë se prindërit, përveç pjesëmarrjes në mbledhje të prindërve, ndihmojnë financiarisht kur

kanë mundësi, por me shuma simbolike, pastaj angazhohen në organizimin e ekskursioneve eventuale, por nuk mund të kontribuojnë në vendimet për programin mësimor sepse për këtë vendos vetëm Ministria e Arsimit.

Përparësia e angazhimit të prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre, sipas profesorëve, është se nëse prindërit vijnë në shkollë për të pa rezultatet e fëmijëve të tyre, atëherë, nxënësit e kuptojnë që prindërit e tyre po interesohen dhe nuk bëjnë mungesa në mësim, por edhe mësojnë sepse e dijnë që prindërit e tyre janë në ngjarje. Ata thonë se takimet me prindërit organizohen drejtpërdrejt katër herë në vit dhe ato janë obligative, por ka raste edhe kur profesorët kontaktojnë me prindërit përmes telefonit dhe shkojnë në shtëpi, por këto janë raste të rralla. Sipas profesorëve të minoritetit turk dhe boshnjak:

Problemi kryesor është mungesa e teksteve, të cilat duhet të përkthehen urgjentisht pasi që nuk po lejohet pëdorimi i teksteve nga Turqia përkatësisht Bosnjë Hercegovina. Pastaj, problem tjetër është se profesorët minoritarë për të plotësuar normën duhet të japin mësim në dy ose më shumë shkolla. Një tjetër problem është papërshtatshmëria e programit për mësimin e gjuhës shqipe për minoritetet dhe, për më keq, profesorët e gjuhës shqipe i vënë nxënësit minoritarë në pozita të palakmueshme ngase u japin për të mësuar poezi shqipe si “O sa mirë me qenë shqiptar”. Po ashtu, komunikimi ynë me autoritetet e shkollës do të ishte më i lehtë sikur zëvendës/drejtori të ishte nga minoritetet.

Për më shumë, profesorët thonë se kanë nevojë për hapësirë më të madhe; për dhoma të veçanta për takime me prindërit, për kabinete për lëndët shkencore, për pasurim të bibliotekës me libra nga gjuhët e minoriteteve, për pedagog, psikolog dhe mjek të shkollës... Po ashtu, ata ankohen se jo që nuk kanë pasë trajnime për angazhimin e prindërve në procesin e edukimit, por as trajnime të natyrave tjera, përderisa shqiptarët kanë pasë trajnime të shumta dhe të natyrave të ndryshme.

Definimi i pjesëmarrjes së nxënësve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e nxënësve minoritarë/ Komunikimi fëmijë-shkollë

Nxënësit e gjimnazit “Gjon Buzuku” thonë se shkolla pret prej tyre që të mësojnë dhe ta ndjekin me rregull procesin mësimor, por edhe të angazhohen në organizimin e aktiviteteve të ndryshme, si, për shembull, në gazetën e shkollës, aktivitetet për ditën e shkollës, në pastrimin e objektit dhe oborrit të shkollës. Përveç këtyre aktiviteteve, nxënësit e kësaj shkolle angazhohen edhe në organizimin e të ashtuquajturës “Dita e ëmbëlsirave”, me ç’rast bëjnë vullnetarisht ëmbëlsira, të cilat i shesin në qytet dhe paratë prej shitjes i dedikojnë në aktivitete humanitare. Nxënësit ankohen:

Për mungesë të hapësirës, të kabineteve të ndryshme, mungesë të inventarit të mjaftueshëm (karriga, tavolina, tabela), mungesa të ujit të mjaftueshëm në shkollë, gjendje të rëndë në toaleta... Për këto probleme, përveç nesh, janë në dijeni edhe profesorët, prindërit, por edhe drejtorja e shkollës.

Nxënësit minoritarë thonë se shkolla nuk i ka ndihmuar për të kuptuar nevojat e tyre mësimore, as nuk ka përdorë ndonjë strategji për ta nxitë pjesëmarrjen e tyre në procesin e edukimit, e as nuk i ka informuar ata për të drejtat që u takojnë si minoritete. Nxënësit e minoritetit turk në këtë shkollë ankohen se lajmërimet në shkollë, përveç në gjuhën shqipe, bëhen edhe në gjuhën boshnjake, por jo edhe në gjuhën turke. Po ashtu, sipas tyre, përderisa nxënësit boshnjakë kanë pushim për Ditën e Boshnjakëve, nxënësit e minoritetit turk nuk kanë pushim për Ditën e Turqve.

Për më shumë, nxënësit e minoritetit turk ankohen se për të vazhduar shkollimin universitar në gjuhën turke duhet të shkojmë në Turqi dhe shumë nxënës të mirë mbesin rrugëve ose bëjnë punë fizike në pamundësi për të shkuar në Turqi për studime. Në anën tjetër, nxënësit boshnjakë nuk kanë probleme me shkollimin universitar sepse në qytetin e Pejës dhe të Prizrenit ka fakultete në gjuhën boshnjake dhe në të ardhmen e afërt parashihet të hapen edhe disa fakultete në gjuhën boshnjake. Por, problemi që kanë nxënësit e minoritetit boshnjak është se edhe nëse duan nuk mund të studiojnë në Serbi, Mal të Zi ose Bosnjë-Hercegovinë sepse këto shtete nuk i pranojnë diplomat e Kosovës, por vetëm ato të UNMIK-ut.

Sipas nxënësve minoritarë, nxënësit shqiptarë kanë komunikim më të shpeshtë dhe më të mirë me autoritetet e shkollës për shkak të mospasjes së barrierave gjuhësore. Ata thonë se zakonisht me drejtorinë komunikojmë përmes profesorëve, prandaj do të ishte mirë që të ketë zëvendës/drejtor nga grupet minoritare (boshnjak/turq). Po ashtu, ata kërkojnë që në Këshillin e Shkollës nxënësit të përfaqësohen jo vetëm me një nxënës, i cili gjithmonë është nga komuniteti shumicë, por të ketë edhe një nxënës nga komuniteti boshnjak dhe një nga komuniteti turk sepse kështu mund të përfaqësohen më mirë nevojat tona.

Nxënësit e minoriteteve në këtë shkollë janë të mendimit se barriera më e madhe është mungesa e teksteve mësimore, përveç për lëndët e gjuhës shqipe, angleze dhe frënge. Për lëndët tjera profesorët kryesisht u diktojnë dhe nuk u lejohet të marrim tekste nga Bosnjë Hercegovina përkatësisht Turqia për shkak të mospërputhjes me planprogramin e Kosovës, andaj ata kërkojnë që ose të hartohen tekstet mësimore ose të lejohet përdorimi i teksteve nga Bosnjë Hercegovina respektivisht Turqia. Përveç nxënësve dhe profesorëve, për këtë problem janë të njoftuar edhe prindërit dhe drejtorja e shkollës, por edhe Drejtorja Komunale për Arsim dhe Ministria e Arsimit.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e prindërve të studentëve minoritarë/ Komunikimi shkollë-shtëpi/ Strategjitë dhe barrierat për angazhimin e prindërve

Për prindërit e nxënësve të gjimnazit “Gjon Buzuku” angazhimi në shkollimin e fëmijëve të tyre nënkupton krijimin e kushteve për mësim për fëmijët e tyre, kujdesin që fëmijët të mos bëjnë mungesa; të mësojnë; të jenë të sjellshëm, por edhe angazhimin për të kuptuar se për çfarë janë të aftë fëmijët e tyre. Prindërit e nxënësve marrin pjesë në mbledhje, janë të përfaqësuar në organet si Këshilli i Prindërve dhe Këshilli i Shkollës, ku japin ide për çështje të administrimit të shkollës, si ideja për të

bërë një ueb faqe të shkollës. Prindërit janë të mendimit se duhet të rriten rrogat për profesorët dhe bashkë me rrogat edhe orari i punës në tetë orë për çdo ditë sepse profesorët duhet t’i mësojnë nxënësit se si të mësojnë, e jo të pajisin me diploma njerëz që nuk mund të bëjnë asnjë punë.

Prindërit thonë se bashkë me shkollën kanë zgjidhur disa probleme, e problemi më kryesor, sipas tyre, ka qenë se shumë nxënës pinin duhan në shkollë, kështu që është marrë vendim që në shkollë të ndalohet rreptësisht pirja e duhanit dhe kjo ka ndikuar që të zvogëlohet dukshëm prija e duhanit. Po ashtu, me mbështetjen financiare të prindërve është bërë sigurimi i shkollës për shkak të problemeve që dilnin si pasojë e mos sigurimit: futeshin njerëz të panjohur që i ngacmonin nxënësit, u vidhnin nxënësve gjëra me vlerë... Pastaj projekt tjetër i rëndësishëm ku kanë marrë pjesë prindërit ka qenë edhe uniformimi i nxënësve, që ka ndikuar pozitivisht në sigurinë në shkollë. Këta shembuj, sipas prindërve, tregojnë se pjesëmarrja e prindërve në procesin arsimor është shumë e rëndësishme. Sipas tyre një projekt shumë të rëndësishëm që e ka bërë shkolla, përveç vendosjes së kamerave në shkollë, është edhe vendosja e një kutie, ku prindërit dhe nxënësit mund t’i vendosin vërejtjet e tyre.

Mirëpo, sipas prindërve, meqenëse klasat e mësimi në këtë gjimnaz kanë kapacitet për më së shumti 30 nxënës, do të ishte mirë që të mos pranohen deri në 40 nxënës për klasë sepse më pas nuk ka karriga dhe banka të mjaftueshme. Prindërit thonë edhe se shkolla duhet të hapë e-mail zyrtar dhe të ketë një të punësuar aty që u përgjigjet e-mail-ave të prindërve që dërgojnë në adresë të shkollës për shqetësimet që kanë. Pastaj, tabela e informimit në shkollë, e cila është e mbushur me materiale në gjuhën shqipe, duhet t’i ketë të gjitha materialet edhe në gjuhën turke e boshnjake, edhe pse shumica mund ta kuptojnë përmbajtjen, por nëse është edhe në gjuhët e minoritarëve atëherë respektohet e drejta për t’u informuar në gjuhën amtare. Por, prindërit thonë se edhe përkundër kësaj, komunikimi verbal me autoritetet e shkollës është shumë i mirë sepse autoritetet e shkollës kanë shumë kujdes dhe respekt për minoritetet. Ata thonë se nuk e dinë të ketë pasë ndonjëherë mosmarrëveshje mes prindërve minoritarë dhe shkollës. Sipas tyre:

Problemi më i madh është mungesa e teksteve dhe për këtë Ministria e Arsimit e Kosovës duhet të bëjë një marrëveshje me Ministrinë e Arsimit të Bosnjës dhe Turqisë ose të përkthehen tekstet nga gjuha shqipe në gjuhën boshnjake dhe turke. Probleme tjera janë edhe: sigurimi i transportit për nxënësit që jetojnë larg prej shkollës; ndërtimi i një biblioteke në shkollë me më shumë libra në gjuhën boshnjake/turke, ku nxënësit mund të mësojnë pas mësimi; binjakëzimi me shkolla të vendeve përreth; vizita në muze; kuize të diturisë, përzgjedhje të talentëve për gara ndërkombëtare...

Prindërit thonë se të gjitha problemet i kanë paraqitë në Këshillin e Prindërve, Këshillin e Shkollës, Drejtorinë Komunale të Arsimit. Barrierë kryesore për angazhim më të madh të prindërve në shkollim të fëmijëve të tyre është për disa mungesa e kohës e për pjesën më të madhe gjendja e rëndë ekonomike. Ata kërkojnë që patjetër zëvendës-drejtori i shkollës të jetë nga minoriteti boshnjak/turk. Edhe përkundër vërejtjeve që kanë, prindërit thonë se nuk kanë menduar ta ndërrojmë shkollën për

fëmijët e tyre sepse, sipas tyre, në Kosovë nuk ka më mirë. Ideja e tyre për përmirësimin e relacioneve mes shkollës dhe prindërve konsiston në shpeshimin e kontakteve, por përmes telefonit dhe e-mail-it sepse kështu kursehet kohë dhe prindërit informohen me shpejt.

2.3. Shkolla e mesme ekonomike “Ali Hadri” - Pejë

Shkolla e mesme ekonomike “Ali Hadri” në Pejë është themeluar në vitin 1946. Deri në mes të viteve 60-ta mësimi është zhvilluar vetëm në gjuhën serbe, edhe pse nxënësit kanë qenë të të gjitha komuniteteve. Në fund të viteve 60-ta mësimi ka filluar edhe në gjuhën shqipe. Meqë në vitin 1990 pushteti serb largon shqiptarët nga objektet shkollore, mësimi zhvillohet në shtëpi private dhe në këtë kohë shkolla merr emrin e historianit shqiptar Ali Hadri. Prej 12 qershorit të vitit 1999, kur forcat serbe largohen nga Kosova, mësimi zhvillohet sërish në objektet shkollore. Sot kjo shkollë ka 1600 nxënës dhe 112 profesorë, ku 90 nxënës dhe 13 profesorë janë të minoritetit boshnjak. Në këtë shkollë janë gjithsej 16 profile: ekonomia e përgjithshme, kontabiliteti, banka dhe sigurime, tregëtia me shumicë dhe pakicë, logjistika, shpeditoni, doganat, administrimi i biznesit, asistent juridik, asistent i administratës, organizator i aktiviteteve shoqërore, asistent i restorantit, asistent i hotelerisë dhe teknik turistik, teknologji ushqimore, veterinari dhe pylltari.

Studimi i idesë së pjesëmarrjes dhe angazhimit në mësim/ Strategjia e shkollës për të mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e prindërve/nxënësve/ Motivimi i prindërve/nxënësve/ Pengesat dhe barrierat për pjesëmarrje dhe angazhim/ Përgatitje të veçanta për nxënësit minoritarë

Drejtorja e shkollës së mesme ekonomike “Ali Hadri” thotë se prindërit nuk po tregojnë interesim të madh për të qenë pjesëmarrës në procesin mësimor. Edhe pse shkolla diskuton çdo herë për ta rritë pjesëmarrjen e prindërve në shkollë, nuk ka të hartuar program konkret për këtë problematikë, e as nuk është e njoftuar nëse Ministria e Arsimit ka ndonjë plan konkret për këtë gjë.

Sipas drejtorisë nxënësit dhe prindërit janë të përfshirë në vendim-marrje në shkollë meqë organi më i lartë në shkollë, Këshilli i Shkollës, pa pëlqimin e të cilit nuk mund të merret asnjë vendim, është i përbërë përveçse nga pesë profesorë, edhe nga tre prindër dhe një nxënës. Drejtori i shkollës është edhe sekretar i Këshillit të Shkollës, por nuk ka të drejtë vote. Anëtarët e Këshillit të Shkollës nga radhët e prindërve zgjedhen nga prindërit dhe, për më shumë, Këshilli i Shkollës kryesohet nga përfaqësuesit e prindërve, ku asnjë vendim nuk mund të merret pa pëlqimin e prindërve/nxënësve, edhe pse aty ka më shumë profesorë. Këshilli i Shkollës mund të marrë vendime për shkollën përkatësisht menaxhimin e shkollës: ekskursionet brenda dhe jashtë vendit, trajnimet e mësimdhënësve, pjesëmarrja nëpër panaire të ndryshme, të hyrat vetanake të shkollës...²

² Sipas drejtorisë së shkollës së mesme ekonomike “Ali Hadri”, Ministria e Arsimit këtë vit planifikon të fillojë decentralizimin e shkollës në tre hapa: a) financat, ku të hyrat e shkollës do t'i menaxhojë shkolla; por edhe planifikimin financiar, në bashkëpunim me Drejtorinë Komunale të Arsimit, do ta

Drejtorja e shkollës thotë se pret nga prindërit që të ndikojnë te fëmijët e tyre ta vijnë mësimin me rregull, të kenë suksese në mësim dhe të mos bëjnë probleme. Sipas tyre, prindërit duhet të gjejnë kohë për të ardhë në shkollë sepse as 30% e prindërve nuk vijnë në mbledhje, por ata që vijnë përpiqen të ndihmojnë, mirëpo këto janë raste të rralla sepse nxënësit këtu janë nga fshatrat dhe shumica janë të varfër, por ka raste edhe kur prindër të caktuar nuk vijnë në shkollë sepse u vjen turp ngaqë e dijnë që fëmijët e tyre nuk mësojnë, nuk e vijnë mësimin dhe bëjnë probleme. Për më keq, sipas drejtorisë, ka disa raste kur prindërit nuk kanë ardhë në shkollë asnjëherë për katër vjet të shkollimit të fëmijëve të tyre. Mirëpo, një pjesë e prindërve janë të angazhuar sepse janë të vetëdijshëm se kjo ka rëndësi për fëmijët e tyre: iniciativa për angazhimin e sigurimit të shkollës, për çka secili prind paguan 5 euro çdo vit; iniciativa për uniformat e nxënësve në shkollë.

Drejtorja thotë se pjesëmarrja e nxënësve në procesin e vendim-marrjes është e rëndësishme sepse askush më mirë se ata vetë askush nuk mund t’i mbrojnë interesat e tyre dhe kjo është arsyeja përse kërkojmë mendimin e tyre për çdo gjë në shkollë edhe pse ka shumë pak sugjerime nga ana e tyre. Drejtorja ka në plan që bashkë me nxënësit/prindërit të zgjidhin disa probleme të shkollës, siç është thurja e oborrit të shkollës, në mënyrë që të mos mund të hyjnë persona të paautorizuar; të bëjë gjelbërimin e oborrit të shkollës; të vendosin ne oborrin e shkollës ulëse por edhe kontenjerë për hudhjen e mbeturinave.

Sipas drejtorisë problemi më i madh që kanë nxënësit e komunitetit boshnjak është mungesa e teksteve në gjuhën boshnjake, të cilat Ministria e Arsimit duhet t’i bëjë sa më parë. Po ashtu, të gjitha materialet që vijnë nga Ministria e Arsimit janë vetëm në gjuhën shqipe dhe drejtorja i përkthen ato dhe ua kumton nxënësve boshnjakë në gjuhën e tyre, prandaj këto materiale kërkon të vijnë edhe në gjuhën boshnjake. Drejtorja thotë se nuk ka barriera gjuhësore për nxënësit boshnjakë sepse shumica e profesorëve flasin gjuhën boshnjake, por edhe nxënësit boshnjakë mësojnë vullnetarisht gjuhën shqipe çdo javë nga katër orë dhe shumë prej tyre kuptojnë shqip. Sipas drejtorisë nxënësit boshnjakë janë të përfshirë në aktivitetet e shkollës, si dita e shkollës, ku kanë programin e tyre kulturor dhe prezantojnë veshjet e tyre. Drejtorja thotë:

Nxënësit e minoriteteve në shkollën tonë janë të diskriminuar pozitivisht. Për shembull, për shkaqe sigurie ata i kemi vendosur në ndërrimin e paraditës ngase kemi pasë frikë se mund t’u ndodhë gjë në ndërrimin e pasdites edhe pse nuk u ka ndodhë kurrë asgjë. Kemi dashur të sigurojmë transport të veçantë prej fshatërave Vitomiricë dhe Dobrushë nga vijnë nxënësit boshnjakë, diku 10 km larg prej shkollës, mirëpo prindërit e nxënësve boshnjakë kanë kërkuar të sigurohet transport i përbashkët për boshnjakët dhe shqiptarët.

bëjë shkolla; b). përzgjedhja e personelit mësimor; c) organet drejtuese të shkollës do të zgjedhen nga shkolla.



**Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Komunikimi shtëpi-shkollë/
Komunikimi me Prindërit e Nxënësve Minoritarë/ Mbështetja e profesorëve për
përmirësimin e pjesëmarrjes së prindërve**

Për profesorët e shkollës së mesme ekonomike “Ali Hadri” pjesëmarrja e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre është e rëndësishme sepse duke interesuar për mësimnxënien, vijueshmërinë dhe diciplinën e fëmijëve të tyre, ata kontribuojnë që të ketë edukim të suksesshëm. Ata thonë se diku 1/3 e prindërve marrin pjesë në mbledhje dhe kjo ngjet për arsye të gjendjes së rëndë ekonomike, nivelit të arsimimit të tyre, mungesës së perspektivës – shumica e nxënësve që e kryejnë shkollën e mesme janë të interesuar të dalin jashtë Kosovës – por, një pjesë edhe për arsye se i kanë fëmijët nxënës të dobët.

Profesorët thonë se komunikojnë me prindërit përmes mbledhjeve, telefonit, por ka raste edhe kur shkojnë në shtëpi, por këto janë raste ekstremisht të rralla. Ata thonë se nuk kanë ide se si t’i angazhojnë më shumë prindërit, përveç se t’i dënojnë nxënësit që nuk i sjellin prindërit, duke i përjashtuar nga shkolla, edhe pse në bazë të ligjit kanë të drejtë t’i përjashtojnë jo më shumë se 3 deri 5 ditë.

Profesorët thonë se nxënësit boshnjakë janë të përfshirë në aktivitetet si dita e shkollës, ku ata recitojnë poezi boshnjakisht dhe prezantojnë veshjet kombëtare, por jo edhe në ekskursionet që organizon shkolla, meqë ato bëhen vetëm për në Shqipëri, ku shkojnë vetëm nxënësit shqiptarë, ndërsa nxënësit boshnjakë janë të interesuar të shkojnë në Bosnjë-Hercegovinë ose në Mal të Zi, por nuk mundën sepse ka shumë pak nxënës boshnjakë dhe gjendja ekonomike e shumicës prej tyre është e rëndë.

Profesorët thonë se drejtorja e shkollës është korrekte me ta dhe ndihen të përfaqësuar në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me shkollën, meqë njëri prej profesorëve në Këshillin e Shkollës është nga komuniteti boshnjak. Edhe përkundër faktit se përfaqësuesit e drejtorisë së shkollës komunikojnë në gjuhën boshnjake dhe janë korrekt, profesorët boshnjakë kërkojnë që një zëvendës drejtor i shkollës të jetë nga profesorët e komunitetit boshnjak sepse kjo do ta lehtësonte edhe më shumë komunikimin.

Profesorët thonë se nuk kanë pasë asnjëherë trajnime për pjesëmarrjen e prindërve në procesin mësimor, por kanë pasë trajnime tjera nga organizata të ndryshme ndërkombëtare në bashkëpunim me Qendrën Didaktike në Pejë. Përveç kësaj, profesorët kanë vërejtje për kushtet e punës: mungesa e teksteve mësimore, përveç teksteve për gjuhën angleze; mungesa e kabineteve për fusha të ndryshme, mungesa e inventarit: tavolina, karriga, tabela, stufa... Po ashtu, ata kërkojnë nga nxënësit që të kenë më shumë aktivitete jashtëshkollore: sportive, kulturore, ambientale... Ata ankohen se:

Përveç Fakultetit të Biznesit në Pejë dhe Fakultetit të Edukimit në Prizren, të cilat janë në gjuhën boshnjake, për drejtimit tjera nxënësit duhet të shkojnë në Mal të Zi ose në Bosnjë Hercegovinë, por edhe në Novi Pazar, mirëpo Serbia nuk i njeh diplomat nga Kosova dhe duhet të paguajnë para si studentë të jashtëm. Një pjesë e

vogël e nxënësve boshnjakë që zotëron mirë gjuhën shqipe regjistrohen në Universitetin e Prishtinës, ku ligjëratat i ndjekin në gjuhën shqipe, kurse provimet mund t’i japin në gjuhën boshnjake.

Definimi i pjesëmarrjes së nxënësve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e nxënësve minoritarë/ Komunikimi fëmijë-shkollë

Nxënësit e minoritetit boshnjak në shkollën e mesme ekonomike “Ali Hadri” thonë se shkolla pret prej tyre që të mësojnë, ta ndjekin me rregull procesin mësimor, të jenë të diciplinar dhe të angazhohen në organizimin e aktiviteteve të ndryshme. Ata konsiderojnë se kur ka mundësi, shkolla i merr parasysh kërkesat e tyre dhe për këtë ata ofrojnë si shembull kërkesën e tyre për ta ndjekur mësimin paradite për arsye të sigurisë, posaçërisht për femrat. Mirëpo, ata ankohen se:

Në asnjë lëndë nuk kemi tekste mësimore. Marrim shënime në çdo lëndë, përveç në anglisht. Po ashtu, një tjetër problem shumë i madh, meqë kjo është shkollë profesionale, është mungesa e profesorëve të kualifikuar, mungesa e kabineteve, posaçërisht për lëndë profesionale, mungesa e praktikës në disa drejtime, mungesa e tavolinave, karrigave, tabelave, por edhe e ngrohjes më të mirë dhe e detyrve e dritareve më të mira...

Nxënësit thonë se për të gjitha këto probleme janë ankuar te prindërit dhe profesorët, e ata janë ankuar në drejtorinë e shkollës, por edhe në organet komunale për arsim dhe kanë marrë vetëm premtime. Nxënësit minoritarë të kësaj shkolle nuk ndihen të përfaqësuar në organet e nxënësve, por as në aktivitetet tjera si ekskursionet. Për më keq, ata thonë se ka disa nxënës shqiptarë që janë të interesuar për të bërë probleme me ta vetëm se janë boshnjakë, por këto nuk janë shumë raste të shpeshta, ndërsa, në anën tjetër, ata thonë se me drejtorinë dhe profesorët nuk kanë asnjë problem.

Profesorët, sipas nxënësve, sillen njëjtë me të gjithë nxënësit pa kurrfarë dallimi, por natyrisht që komunikimi mes nxënësve shqiptarë dhe drejtorisë së shkollës është më i shpeshtë e më i afërt për shkak të gjuhës... Gjysma e nxënësve të minoritetit boshnjak në këtë shkollë flasin gjuhën shqipe, mirëpo prapëseprapë nxënësit që kanë nevojë të komunikojnë me profesorët shqiptarë ose me drejtorinë e shkollës shkojnë të shoqëruar me profesorë boshnjakë. Nxënësit thonë se drejtoria sillet mirë, por shumë më i mirë do të ishte komunikimi sikur zëvendës-drejtori të ishte nga komuniteti i profesorëve boshnjakë.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e prindërve të studentëve minoritarë/ Komunikimi shkollë-shtëpi/ Strategjitë dhe barrierat për angazhimin e prindërve

Për prindërit e nxënësve minoritarë të shkollës së mesme ekonomike “Ali Hadri” angazhimi i prindërit nënkupton vëzhgimin e fëmijës në shkollë, që nënkupton takime me mësimdhënësit dhe biseda me nxënësit. Shkolla ka Këshillin e Prindërve, ku prindërit mundohen që me propozimet e tyre të ndihmojnë shkollën, por edhe financiarisht ose për mbledhjen e donacionave për ndonjë aktivitet humanitar, mirëpo

kushtet e rënda ekonomike bëjnë që prindërit të mos jenë të angazhuar sa duhet. Sipas prindërve, do të ishte mirë të bëhej një zyre brenda shkollës, ku do të punonte me orar të plotë dhe me pagë një prind, i cili do të ishte në rrjedha vazhdimisht se çfarë po ndodhë në shkollë, cilat janë nevojat e nxënësve, e kështu me radhë. Prindërit thonë se shkolla pret prej tyre që të vijnë më shpesh në shkollë e të shohin nëse fëmijët e tyre po vijnë në mësimin dhe po mësojnë.

Prindërit tregojnë se drejtorja i informon ata se cilat janë drejtimet ku shkolla mund të ofrojë kushte më të mira, në mënyrë që ata t'i orientojnë fëmijët e tyre, sepse ata duhet të profilizohen në klasën e 11-të, e shumë drejtime nuk mund të zhvillohen në gjuhën boshnjake për arsye financiare apo të mungesës së materialit mësimdhënës, mosbashkëpunimit me komunitetin e biznesit, barrierave gjuhësore...

Prindërve minoritarë u kujtohet dita kur kanë regjistruar fëmijët e tyre në shkollë sepse janë gëzuar për shkak se bëhet fjalë për edukimin e fëmijëve të tyre, por thonë edhe se janë pikëlluar sepse kushtet në shkollë janë jo të mira për shkak të mungesës së teksteve mësimore, mungesës së profesorëve të kualifikuar, mungesës së laboratorëve, por edhe mungesës së hapësirës së bollshme, karrigave, tavolinave, tabelave... Për të gjitha këto janë në dijeni organet kompetente.

Prindërit e nxënësve të komunitetit boshnjak në këtë shkollë thonë se shkolla komunikon me ta kryesisht përmes mbledhjeve të prindërve dhe me shumë respekt. Ata thonë se shkolla i kontakton për t'u komunikuar suksesin në mësim/vijueshmërinë në shkollë dhe sjelljet e fëmijëve të tyre. Sipas tyre, shqiptarët, si shumicë në këtë shkollë, takohen me shkollën më shpesh sesa prindërit boshnjakë, shumica e të cilëve vijnë nga fshatërat dhe janë shumë të varfër. Përveç gjërave të lartpërmendura, prindërit ankohen për:

Mungesë të trajnimeve për mësimdhënësit; mungesë të projekteve nga shkolla për angazhimin e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre, mungesë të masave ndëshkuese sepse për dhjetë vite asnjë nxënës i komunitetit boshnjak nuk e ka përsëritur vitin shkollor; mungesë të një zyreje të prindërve, mungesë të një ueb faqeje, ku prindërit do të informoheshin për të gjitha aktivitetet që ndodhin në shkollë, mungesë të pedagogut, psikologut dhe mjekut të shkollës.

2.4. Gjimnazi “Zenel Hajdini” - Gjilan

Gjimnazi “Zenel Hajdini” në Gjilan është themeluar në vitin 1945. Prej vitit 1954 u reduktua dukshëm numri i paraleleve me nxënës shqiptarë, por nga viti 1966 filloi të rritet numri i paraleleve në gjuhën shqipe, ndërsa nga viti shkollor 1972/73 filluan punën paralelet e ndara të gjimnazit në fshatin Zhegër, e më pas edhe degët e këtij gjimnazi në Bujanoc, Kamenicë dhe Viti. Aktualisht ky gjimnaz ka 2463 nxënës dhe 3550 m² që i bie 1.44m² për nxënës. Mësimi zhvillohet me tri ndërrime me 30 minuta ora për shkak të hapësirës së pamjaftueshme dhe numrit të madh të nxënësve. Shkolla ka 115 arsimtarë. Në këtë shkollë ka 34 nxënës të minoritetit turk dhe 9 profesorë. Ky gjimnaz ka 5 drejtime: drejtimi i përgjithshëm; drejtimi matematikë-informatikë; drejtimi i shkencave natyrore; drejtimi i shkencave shoqërore dhe drejtimi lingvistik.

Studimi i idesë së pjesëmarrjes dhe angazhimit në mësim/ Strategjia e shkollës për të mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e prindërve/nxënësve/ Motivimi i prindërve/nxënësve/ Pengesat dhe barrierat për pjesëmarrje dhe angazhim/ Përgatitje të veçanta për nxënësit minoritarë

Gjimnazi “Zenel Hajdini” nuk ka asnjë program për ta nxitë pjesëmarrjen e prindërve në procesin mësimor të fëmijëve të tyre. Po ashtu, sipas drejtorisë, as Minsitria e Arsimit nuk ka ndonjë plan për ta nxitë pjesëmarrjen e prindërve në shkollë, përveçse kohëve të fundit janë organizuar disa takime për shkak të dhunës në shkollë, ku është kërkuar që prindërit të jenë shumë më të angazhuar dhe të kontaktojnë më shpesh me personelin e shkollës. Sipas drejtorisë, profesorët janë të detyruar që t’i angazhojnë prindërit në procesin mësimor sepse gati secili profesor – përveç profesorëve të vjetër – është kujdestar i ndonjë klase dhe ata kanë takime me prindërit së paku katër herë në vit. Shkolla thotë se prindërit kanë fuqi reale vendim-marrëse sepse ata e udhëheqin Këshillin e Shkollës, i cili përbëhet nga tre prindër, një nxënës dhe pesë profesorë.

Drejtorja thotë se kërkon nga nxënësit që ta vijojnë mësimin, të mësojnë dhe të jenë të disiplinuar, kurse nga prindërit t’i motivojnë fëmijët e tyre dhe të vijnë rregullisht në shkollë për t’u interesuar për ta sepse kështu kontribuojnë në pengimin e dukurive si dhuna, duhani, droga, e kështu me radhë.

Drejtorja e shkollës pohon se prindërit ndihmojnë shumë në shkollë dhe për këtë ofron si shembull rastet kur prindërit kanë ndihmuar materialisht, për shembull, për të ble ngjyrë për gëlqerosjen e shkollës; për të ble lëndë djegëse për ngrohjen e shkollës; për riparimin e dymëve e dritareve të shkollës, e kështu me radhë. Por, sipas drejtorisë, shkolla planifikon të ketë dy projekte, ku bartës do të jenë nxënësit, njëri që ka të bëjë me rendin dhe pastërtinë në shkollë, kurse tjetri ka të bëjë me të drejtat e nxënësve dhe me postën e fshehtë për vlerësimin e mësimdhënësve.

Këshilli i Shkollës është organi më i lartë dhe vendimet aty merren me shumicë votash, e edhe pse prindërit/nxënësit mund të mbivotohen, sipas drejtorisë së shkollës një gjë e tillë nuk ka ndodhë asnjëherë. Secila klasë zgjedhë vetë nga dy prindër përfaqësues në Këshillin e Shkollës, të cilët më pas zgjedhin Këshillin e Prindërve të Shkollës, i cili përbëhet nga 11 prindër dhe dërgon përfaqësuesit e vet në Këshillin e Shkollës. Për zgjedhjen e prindërve përfaqësues merret parasysh vullneti për aktivitete.

Sipas drejtorisë prindërit janë të interesuar të marrin pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë sepse janë në pyetje fëmijët e tyre, por ka raste, edhe pse të rralla, kur nuk janë të interesuar. Për më shumë, prindërit angazhohen në aktivitete jashtëprogramore si ekskursionet brenda dhe jashtë vendit. Drejtorja thotë se nuk ka strategji për të inkurajuar pjesëmarrjen e prindërve në procesin e edukimit.

Në lidhje me të drejtat e grupeve minoritare, drejtorja nuk i informon prindërit/nxënësit e grupeve minoritare për të drejtat që u takojnë atyre. Drejtorja

thotë se kur shkolla ka aktivitete fton edhe minoritarët për të marrë pjesë. Sipas drejtorisë, nxënësit minoritarë nuk kanë kurrfarë barrierash gjuhësore për të komunikuar me autoritetet shkollore, meqë komunikojnë lirshëm në gjuhën shqipe, e po ashtu, nuk ka mosmarrëveshje as mes profesorëve në shkollë dhe nxënësve që u takojnë grupeve minoritare etnike.

Definimi i pjesëmarrjes së nxënësve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e nxënësve minoritarë/ Komunikimi fëmijë-shkollë

Nxënësit minoritarë të gjimnazit “Zenel Hajdini” mendojnë se shkolla pret prej tyre që të ndjekin me rregull procesin mësimor, të mësojnë, të jenë të disiplinuar dhe të merren edhe me aktivitete jashtë-mësimore si: aktivitete sportive, kulturore apo tjetërfare. Ata thonë se të jesh nxënës minoritar dallimi i vetëm është numerik dhe, për më shumë, sipas tyre, kushtet për mësim janë më të mira për nxënësit minoritarë sepse janë nga 10 deri 12 nxënës, ndërsa nxënësit mazhoritarë janë nga 40 nxënës në klasë.

Nxënësit pohojnë se nuk janë të përfaqësuar në Rininë Shkollore, por janë të angazhuar në aktivitetet kulturore dhe sportive në shkollë, e edhe në aktivitetet që organizohen për ditën e shkollës. Për ta pjesëmarrja e nxënësve në rininë shkollore është e rëndësishme sepse duan që të jenë të angazhuar në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me ta.

Ata thonë se shkolla nuk i njofton për të drejtat që u takojnë atyre si nxënës të minoritetit, por shprehen të kënaqur që tash e tutje, nxënësit e komunitetit turk më 23 prill të çdo viti, që është “Dita e Turqve”, do të jenë të liruar nga mësimi dhe kjo për ta është shenjë e respektimit të të drejtave të tyre si minoritarë, edhe përkundër faktit se në këtë ditë shkolla nuk organizon asnjë aktivitet.

Sipas tyre nuk ka kurrfarë barriere për të komunikuar me drejtorinë e shkollës, madje as gjuhësore sepse të gjithë nxënësit flasin edhe shqip dhe komunikimi mes drejtorisë/profesorëve dhe nxënësve minoritarë është i njëjtë sikurse me të tjerët, edhe pse nxënësit shqiptarë komunikojnë më lehtë me shkollën për shkak të gjuhës. Ata thonë se nuk kanë probleme me shkollën, por:

Problemi më i madh është se nuk kemi libra në gjuhën tonë. Tërë ora e mësimit shkon duke marrë shënime. Nga 14 lëndë që kemi, libra kemi vetëm për lëndët e gjuhës angleze dhe latine. Problem tjetër është disa lëndë na i japin profesorët shqiptarë dhe nganjëherë nuk i kuptojmë të gjitha gjërat që shpjegohen.

Ata thonë se për këto probleme janë në dijeni profesorët, drejtorja e shkollës dhe prindërit, por deri më tani asgjë nuk është ndërmarrë. Nxënësit pohojnë se shumë herë ushtarët e KFOR-it turk, por edhe shoqata të ndryshme turke, kanë sjellë libra, por profesorët kanë thënë që nuk janë të përdorshme sepse nuk janë në përputhje me planprogramin e Kosovës. Sipas nxënësve do të duhej që sa më shpejtë të hartohen tekstet mësimore ose të përkthehen tekste në gjuhën turke sepse kjo, sipas tyre, po shkakton shumë vështirësi në procesin e mësimnxënies.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Komunikimi shtëpi-shkollë/ Komunikimi me Prindërit e Nxënësve Minoritarë/ Mbështetja e profesorëve për përmirësimin e pjesëmarrjes së prindërve

Profesorët e gjimnazit “Zenel Hajdini” thonë se prindërit duhet të angazhohen në shtëpi me fëmijët e tyre, të shohin nëse ata i kanë kryer detyrat që kanë marrë në shkollë, të vijnë në shkollë më shpesh për të parë nëse fëmijët e tyre po e ndjekin mësimin me rregull, nëse janë të suksesshëm në mësim dhe të dicituluar. Sipas profesorëve, prindërit janë të angazhuar në Këshillin e Prindërve, e ndonjëherë angazhohen edhe në ndonjë aktivitet që organizon shkolla, si ekskursionet në vende të ndryshme të Kosovës edhe pse këto aktivitete janë shumë të rralla. Sipas tyre, kryesisht angazhohen prindërit që janë më të ngritur intelektualisht, por ka edhe përjashtime.

Arsyeja kryesore, sipas tyre, për mosangazhim adekuat të prindërve, është gjendja e rëndë ekonomike e shumicës së prindërve. Profesorët janë të bindur se pjesëmarrja e prindërve ka ndikim shumë të madh në mësimnxënie, vijueshmëri, por edhe disiplinë. Profesorët thonë se takimet e tyre me prindërit bëhen katër herë brenda një viti shkollor, e në rast nevojë edhe më shpesh, por ka raste edhe kur prindërit vijnë në shkollë dhe interesohen pa u ftuar, edhe pse këto raste janë shumë të rralla. Ata thonë se ka raste kur i kontaktojnë prindërit përmes telefonit, por rrallë, ndërsa nuk ka raste kur detyrohen të shkojnë në shtëpi të prindërve/nxënësve.

Sa i përket angazhimit të prindërve të fëmijëve minoritarë, profesorët thonë se nuk ka kurrfarë dallimi dhe se, sipas tyre, prindërit e nxënësve të minoritetit turk janë të përfaqësuar shumë mirë në Këshillin e Prindërve, por edhe në Këshillin e Shkollës dhe nuk kanë kurrfarë barrierash, e as gjuhësore meqë shumica dërrmuese e tyre flasin shumë rrjedhshëm gjuhën shqipe. Sipas tyre shkolla duhet të organizojë takime të veçanta me prindërit për t’i bindë se angazhimi i tyre në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre është shumë i rëndësishëm. Profesorët thonë se nuk kanë pasë trajnime për angazhimin e prindërve në edukimin e fëmijëve – por kanë pasë trajnime tjera, kryesisht të organizuara nga organizata KEC – dhe se nuk kanë ndonjë ide se si t’i nxisim prindërit për t’u angazhuar në procesin e edukimit të fëmijëve të tyre.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e prindërve të studentëve minoritarë/ Komunikimi shkollë-shtëpi/ Strategjitë dhe barrierat për angazhimin e prindërve

Sipas prindërve të gjimnazit “Zenel Hajdini” angazhimi i tyre në procesin mësimor nënkupton që ata të bashkëpunojnë me profesorët e fëmijëve të tyre, por edhe me drejtorinë e shkollës dhe të marrin pjesë në zgjidhjen e problemeve në shkollë. Ata thonë se prindërit kanë rol në marrjen e vendimeve në shkollë sepse kanë Këshillin e Prindërve, përfaqësuesit e të cilit janë në Këshillin e Shkollës, i cili kryesohet nga prindërit. Pengesat kryesore për mosangazhim më të madh të prindërve, sipas vetë prindërve, janë kushtet ekonomike dhe papërgjegjësia e një pjese të prindërve, të cilët i detyrojnë fëmijët e tyre të punojnë, e kjo ndikon shumë keq sepse fëmijët që punojnë nuk mund të ndjekin mësimin siç duhet. Prindërit kërkojnë që pagat e profesorëve të

minoritetit turk të jenë më të mëdha sepse një profesor i minoritetit turk nuk mund ta plotësojë normën prej 20 orëve në javë me një lëndë, andaj detyrohet të japë të paktën tri lëndë, në mënyrë që ta plotësojë normën.

Prindërit thonë se në shtëpi angazhojnë fëmijët që t’i kryejnë detyrat që marrin në shkollë dhe bëjnë përpjekje që t’i japin përparësi më shumë gjuhës shqipe, meqë është gjuha kryesore në Kosovë, dhe kërkojnë që në këtë aspekt drejtoria e shkollës të bëjë më shumë përpjekje sepse ka nxënës minoritarë që kanë barriera në komunikim për shkak të gjuhës. Ata thonë se në rast nevojë komunikojnë me shkollën edhe kur nuk ka mbledhje dhe marrin pjesë në organizimin e ekskursioneve në Kosovë, por edhe jashtë saj, në Shqipëri, pastaj në organizimin e mbrëmjeve të maturës, e po ashtu edhe në vizita muzeut në Prishtinë, e kështu me radhë. Për ta pjesëmarrja në shkollë është e rëndësishme sepse merren vendime për fëmijët e tyre, por kërkojnë nga shkolla që t’i lajmërojnë prindërit kur mungojnë fëmijët e tyre shkollë.

Ata thonë se fëmijët e tyre në këtë shkollë regjistrohen me kritere shumë të buta sepse kjo është e vetmja shkollë e mesme në Komunën e Gjilanit, ku mësimi zhvillohet në gjuhën turke. Sipas tyre profesorët janë të rinj dhe shumica kanë pak përvojë, mandej disa nuk janë të kualifikuar dhe shumica e tyre vetë i dërgojnë fëmijët e tyre në shkollat në gjuhën shqipe, e jo në gjuhën turke: në komunën e Gjilanit janë 25 profesorë të komunitetit turk, e 80% e tyre i dërgojnë fëmijët për t’u shkolluar në gjuhën shqipe. Por, për prindërit problemi më i madh është:

Mungesa e teksteve mësimore dhe kuadrove. Kemi biseduar me drejtorinë e shkollës, Drejtorinë Komunale për Arsim dhe Ministrinë e Arsimit, por edhe deputetët e minoritetit turk në Kuvendin e Kosovës. Ka kaluar një dekadë dhe nuk është bërë asgjë. Ndoshta do të duhej që në Drejtorinë Komunale për Arsim të ketë ndonjë përfaqësues të komunitetit turk në mënyrë që të merret me problemet e komunitetit turk në komunën tonë.

2.5. Gjinnazi “Hivzi Sylejmani” - Fushë Kosovë

Gjinnazi Hivzi Sylejmani në qytetin e Fushë Kosovës është themeluar në vitin 1972, fillimisht si paralele e ndarë e gjinnazit “Sami Frashëri” në Prishtinë dhe është pavarësuar në vitin 1979. Ky gjinnaz ka 743 nxënës dhe 30 profesorë dhe mësimin e zhvillon në aneksin e shkollës fillore Selman Riza në Fushë Kosovë, i cili ka 540m². Pra, problemi më i madh me të cilin ballafaqohet ky gjinnaz është hapësira, duke e pasë parasysh se për një nxënës ka 1.37m². Në këtë gjinnaz ka tre nxënës të grupit etnik minoritar ashkali.

Studimi i idesë së pjesëmarrjes dhe angazhimit në mësim/ Strategjia e shkollës për të mundësuar pjesëmarrjen dhe angazhimin e prindërve/nxënësve/ Motivimi i prindërve/nxënësve/ Pengesat dhe barrierat për pjesëmarrje dhe angazhim/ Përgatitje të veçanta për nxënësit minoritarë

Gjinnazi “Hivzi Sylejmani” nuk ka ndonjë program për rritjen e pjesëmarrjes së prindërve dhe nxënësve në shkollë, e sipas drejtorisë, nuk ka ndonjë projekt të tillë as

nga Ministria e Arsimit. Drejtorja thotë se është e interesuar për angazhimin e prindërve në procesin e mësimor sepse, sipas tyre, pa angazhimin e prindërve procesi mësimor nuk mund të jetë i suksesshëm sepse prindërit ndihmojnë në jetën shkollë duke u kujdesur që fëmijët e tyre: të vijojnë rregullisht mësimin; t’i kryejnë detyrat mësimore që marrin nga profesorët; të mos shkaktojnë probleme... Sipas drejtorisë prindërit janë të angazhuar në ndërmarrjen e iniciativave në shkollë, siç është iniciativa për uniformimin e të gjithë nxënësve të shkollës dhe angazhimi i rojtarëve, të cilat kanë për obligim që në hyrje-daljet e oborrit të shkollës të mos lejojnë që të futen pa leje persona që nuk janë pjesë e shkollës. Po ashtu, prindërit dhe nxënësit informohen rregullisht për vendimet në të cilat nuk janë të angazhuar drejtpërdrejt.

Në jetën shkollë, prindërit dhe nxënësit janë të angazhuar në Këshillin e Prindërve dhe Rininë Shkollë, por edhe në Këshillin e Shkollës dhe, sipas drejtorisë, kanë ndikim në procesin mësimor dhe përveç në aktivitetet shkollë, ata janë të angazhuar edhe në ato jashtëshkollë. Pjesëmarrja e tyre në trupat shkollë konsiderohet e rëndësishme nga udhëheqësia e shkollës sepse kështu ata i paraqesin shqetësimet e tyre me mbarëvajtjen e procesit mësimor, performimin e profesorëve, sigurinë në shkollë...

Drejtorja thotë se prindërve u pëlqen të marrin pjesë në marrjen e vendimeve të rëndësishme në shkollë sepse merren vendime për fëmijët e tyre. Për të qenë përfaqësues i prindërve nuk nevojiten kushte të përcaktuara. Pa pjesëmarrjen e prindërve nuk mund të merret asnjë vendim. Natyrisht që shumë prindër nuk u përgjigjen ftesave të kujdestarëve as për t’u njoftuar me suksesin përkatësisht mosuksesin e fëmijëve të tyre edhe përkundër faktit se në bazë të rregullores ata janë të obliguar që të paktën katër herë – kjo nuk është e kufizuar – brenda një viti shkollor të takohen me kujdestarin e klasës së fëmijës së tyre.

Nxënësit e komunitetit ashkali, sipas drejtorisë, janë të integruar mrekullisht, kështu që shkolla nuk ka bërë përpjekje të veçanta për të informuar studentët/prindërit e grupeve minoritare për të drejtat e tyre. Për më shumë, ky grup minoritar nuk ka barriera gjuhësore meqenëse gjuha e tij është identike sikurse edhe gjuha e shumicës. Prindërit e nxënësve minoritarë janë të përfshirë në ngjarjet kulturore që ndodhin në shkollë. Barriera kryesore për përfshirjen më aktive të prindërve/nxënësve në procesin e edukimit është gjendja e rëndë ekonomike e shumicës së tyre. Komunikimi i profesorëve me nxënësit minoritarë nuk është aspak ndryshe prej komunikimit të tyre me nxënësit që janë shumicë. Nxënësit minoritarë nuk kanë kurrfarë mosmarrëveshjeje me personelin e shkollës.

Përfitimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre, sipas drejtorisë, konsiston në faktin se rezultatet e fëmijëve të tyre janë më të larta në nxënien e dijes. Po ashtu, me angazhimin e tyre, përveç përfitimit disiplinor, mund të ketë edhe përfitim financiar sepse ka prindër që participojnë financiarisht në nevojat që ka shkolla.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Komunikimi shtëpi-shkollë/ Komunikimi me Prindërit e Nxënësve Minoritarë/ Mbështetja e profesorëve për përmirësimin e pjesëmarrjes së prindërve

Profesorët e gjimnazit “Hivzi Sylejmani” thonë se për ta angazhimi i prindërve është i rëndësishëm dhe pa të nuk mund të funksionojë shkolla siç duhet. Për ta përgjegjësia kryesore e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre është krijimi i të gjitha kushteve për fëmijëve e tyre për edukim. Po ashtu, sipas tyre, prindërit duhet të bisedojnë me fëmijët e tyre se cilat janë vërejtjet e tyre për gjendjen në shkollë, në mënyrë që më pas prindërit të mund të përdorin ndikimin e tyre për ta përmirësuar gjendjen. Prindërit duhet të vijnë në shkollë sepse kështu kontribuojnë që fëmijët të vijnë në shkollë me rregull, të mësojnë dhe të jenë të diciplinar. Ata thonë se:

Shkolla duhet të ketë pedagogun, psikologun dhe mjekun e vet. Po ashtu, shkolla duhet të ketë orë kujdestarie një herë në javë, sikurse që ka pasë dikur, ku do të mund të bisedohej me nxënësit për të gjitha problemet. Mbledhjet me prindër duhet të jenë një herë në muaj sepse katër herë në vit nuk është e mjaftueshme. Në mbledhje të prindërve duhet të marrë pjesë edhe kryesia e klasës. Gjithashtu, duhet të bëhet një zyrë ku prindërit mund të vijnë çdo ditë dhe të adresojnë ankesat, shqetësimet, vërejtjet, sugjerimet, këshillat...

Në Këshillin e Shkollës, që është organi më i lartë në shkollë dhe ku merren të gjitha vendimet, nxënësit janë të përfaqësuar dhe aty paraqesin të gjitha vërejtjet e tyre që kanë të bëjnë me shkollën, por për disa probleme, siç është mungesa e hapësirës, nuk mund të bëhet asgjë sepse ato nuk janë kompetencë e shkollës. Profesorët thonë se prindërit janë të angazhuar në shkollë, por jo sa duhet dhe arsyeja kryesore është gjendja e rëndë ekonomike. Sipas tyre diku afërisht gjysma e prindërve vijnë në shkollë dhe kryesisht vijnë nëse prindërit e nxënësve të mirë, por ka edhe përjashtime.

Arsyet kryesore pse prindërit nuk vijnë në shkollë për t’u interesuar për fëmijët e tyre janë gjendja e rëndë ekonomike dhe niveli i tyre intelektual, e kjo, sipas profesorëve, ndikon shumë sepse kur fëmijët e shohin që prindërit e tyre po interesohen, atëherë, ndryshojnë për të mirë. Profesorët thonë se shkolla nuk ka strategji për ta nxitë pjesëmarrjen e prindërve në shkollë, e cila kohëve të fundit ka qenë e shtuar për arsye se diku 123 nxënës u patën helmuar dhe akoma nuk dihet se si janë helmuar, por, për fat të mirë, kjo tashmë është e tejkaluar.

Profesorët pohojnë se komunikojnë me prindërit përmes mbledhjeve, takimeve individuale në shkollë, por edhe përmes telefonit edhe pse komunikimi me telefon është i rrallë, ndërsa shkuarjet në shtëpi nuk ekzistojnë. Sipas profesorëve do të duhej që nëse prindërit nuk vijnë në shkollë për t’u interesuar për fëmijët e tyre, të përjashtohen fëmijët e tyre nga procesi mësimor, por shkolla ka kompetenca për ta përjashtuar nxënësin vetëm tri deri në pesë ditë, e jo më shumë.

Mes prindërve dhe personelit të shkollës ka mosmarrëveshje vetëm kur fëmijët e tyre përjashtohen ose u thehet nota e sjelljes. Nxënësit minoritarë janë krejtësisht të barabartë, e njëjtë janë edhe prindërit e nxënësve të minoriteteve dhe nuk ka kurrfarë

barrierash. Profesorët thonë se kanë pasë trajnime për aplikimin e metodave më bashkëkohore në procesin edukativ nga organizata të ndryshme ndërkombëtare e posaçërisht nga KEC-i, por nuk kanë pasë trajnime për nxitjen e pjesëmarrjes së prindërve në procesin e edukimit.

Definimi i pjesëmarrjes së nxënësve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e nxënësve minoritarë/ Komunikimi fëmijë-shkollë

Për nxënësit e gjimnazit “Hivzi Sylejmani” angazhimi në shkollë nënkupton vijimin me rregull të mësimin dhe kryerjen e detyrave që marrin nga profesorët. Sipas tyre, angazhimi i tyre ndikon edhe në stimulim e profesorëve për t’u angazhuar. Nxënësit minoritarë thonë se angazhimi i nxënësve nuk ka kurrfarë dallimi për nxënësit minoritarë dhe se janë të diskriminuar pozitivisht si nga profesorët ashtu edhe nga drejtoria, por edhe nxënësit shumicë dhe përgjithësisht nuk kanë mosmarrëveshje me shkollën.

Nxënësit zgjedhin kryetarët e klasave dhe më pas kryetarët e të gjitha klasave të shkollës zgjedhin kryesinë e nxënësve të shkollës, e cila zgjedhë kryetarin e saj dhe përfaqësuesin në Këshillin e Shkollës. Andaj, ata thonë se kanë ndikim sepse kanë përfaqësuesin e tyre në Këshillin e Shkollës, ku merren të gjitha vendimet e rëndësishme që kanë të bëjnë me shkollën. Sipas tyre, pjesëmarrja në vendim-marrje në shkollë është e rëndësishme sepse bëhet fjalë për vetë ata, por edhe sepse kështu mësohen që edhe pas përfundimit të shkollës të marrim pjesë në marrjen e vendimeve që kanë të bëjnë me ta.

Nxënësit nuk kanë të drejtë për të vendosur se si e zhvillojnë profesorët procesin mësimor, por as se çfarë të mësojnë sepse për këtë vendos Ministria e Arsimit, por ata marrin pjesë në qeverisjen e shkollës dhe në organizimin e aktiviteteve që organizohen në shkollë për: Ditën e Ambientit, Ditën e Dhurimit të Gjakut, Ditën e Pavarësisë së Kosovës, Ditën e Pavarësisë së Shqipërisë, Ditën e Shkollës, por edhe aktivitete humanitare për të mbledhë para kur ndonjë nxënës është i sëmurë dhe nuk ka para për t’u shëruar, ndërsa për Ditën e Ashkalinjve (15 shkurt) nuk ka program dhe ka mësim.

Nxënësit thonë se shkolla nuk i ka informuar – qoftë përmes takimeve apo shpërndarjes së ndonjë materiali – për të drejtat që u takojnë si minoritete dhe, sipas tyre, kjo është mirë sepse kështu konsiderohemi të njëjtë meqë edhe kemi gjuhë të njëjtë. Ata, po ashtu, pohojnë se nuk kanë probleme me autoritetet shkollore apo me profesorët edhe pse, sipas tyre, shkolla nuk ka bërë ndonjë gjë për të ditë nevojat tona.

Për sa i përket angazhimi të nxënësve në shkollë, nxënësit thonë se duhet organizimi i garave të ndryshme në shkollë, ku nxënësit e dalluar do të shpërbleheshin me mirënjohje sepse, sipas tyre, kjo do të nxiste nxënësit për të mësuar. Po ashtu, do të ishte mirë që në lëndë të caktuara të ketë debate ngase kështu shkolla duhet të bëhej atraktive për nxënësit, e jo obligative. Nxënësit thonë se nuk janë të kënaqur jo vetëm se disa profesorë nuk janë të kualifikuar e disa nuk kanë vullnet për të punuar për

shkak të pagës së vogël, por edhe për arsye profesorët duhet të trajnohen për të përdorë metoda të reja të mësimnxënies, por edhe mënyra e komunikimit të tyre është jashtëzakonisht zyrtare sepse ata dëshirojnë që nxënësit të kenë frikë prej tyre. Për më shumë, sipas nxënësve, një numër i vogël i profesorëve edhe përdorë dhunë ndaj nxënësve kur ata nuk janë të dicitlinuar apo nuk mësojnë.

Nxënësit thonë se projekti i përbashkët mes shkollës dhe prindërve e nxënësve që të gjithë nxënësit të kenë uniforma dhe të mos mund të hynë as në oborr të shkollës pa to, e ka rritë ndjeshëm sigurinë në shkollë. Ata kërkojnë që ora mësimore të mos jetë e atillë që vetëm profesori të flasë, por të ketë debat dhe të përfshihen edhe nxënësit, e po ashtu shkolla të ketë hapësirë më të madhe sepse në një klasë ka dyfish më shumë nxënës sesa që ka kapacitet dhe kjo e vështirëson mbarëvajtjen e procesit mësimor.

Definimi i pjesëmarrjes së prindërve në edukim/ Mundësitë për angazhim/ Pjesëmarrja e prindërve të studentëve minoritarë/ Komunikimi shkollë-shtëpi/ Strategjitë dhe barrierat për angazhimin e prindërve

Për prindërit e nxënësve të gjimnazit “Hivzi Sylejmani” angazhimi në shkollë nënkupton në radhë të parë krijimin e kushteve për të mësuar, pastaj interesimin për të pa nëse fëmijët e ndjekin me rregull procesin mësimor, nëse mësojnë dhe nëse janë të dicitlinuar dhe, sipas tyre, këtë gjë e pret edhe shkolla prej tyre. Për ta angazhimi i prindërve nuk nënkupton tjetër gjë për prindërit e nxënësve të minoriteteve etnike dhe të gjithë prindërit, sikurse edhe nxënësit, janë krejtësisht të barabartë.

Prindërit thonë se kanë ndikim në marrjen e vendimeve në shkollë sepse janë të përfaqësuar në Këshillin e Prindërve dhe në Këshillin e Shkollës dhe ky përfaqësim është i rëndësishëm sepse bëhet fjalë për fëmijët tonë. Prindërit e nxënësve, përveç pjesëmarrjes në mbledhje dhe ofrimit të ndonjë ndihme simbolike financiare, nuk kanë pasë mundësi të ndihmojnë në vendimet për programet mësimore sepse një gjë e tillë nuk është e lejuar. Prindërit thonë se problemi më i madh me të cilin ballafaqohen nxënësit është mungesa e hapësirës, e cila e vështirëson shumë procesin mësimor.

Prindërit e nxënësve të minoritetit ashkali e kujtojnë shumë mirë ditën kur i kanë regjistruar fëmijët e tyre në këtë gjimnaz sepse ata, për dallim prej fëmijëve shqiptarë, janë regjistruar me procedurë më të lehtë. Ata pohojnë se drejtoria nuk i ka informuar për të drejtat që u takojnë si prindër të fëmijëve minoritarë në asnjë formë dhe nuk i ka ftuar ndonjëherë për të marrë pjesë në ndonjë ngjarje kulturore të organizuar nga shkolla.

Prindërit e nxënësve të minoriteteve pohojnë se nuk kanë probleme për të komunikuar me drejtorinë e shkollës, e as nuk kanë mosmarrëveshje me drejtorinë e shkollës. Ata thonë se komunikojnë me shkollën përmes mbledhjeve që mbahen katër herë në vit, por thonë se intersohen edhe kur nuk ka mbledhje. Ata nuk pranojnë asnjëherë raporte me shkrim nga shkolla për suksesin ose mosp suksesin e fëmijëve të tyre. Sipas tyre shkolla nuk ka strategji për angazhimin e prindërve në edukimin e fëmijëve të tyre. Prindërit tregojnë se barriera kryesore e prindërve për t’u angazhuar më shumë në procesin mësimor është gjendja e rëndë ekonomike.

REKOMANDIMET

- do të ishte mirë që sa më parë të hartohen ose përkthehen tekstet mësimore për nxënësit e minoritetit boshnjak dhe turk, shumica e dërrmuese e të cilave mungojnë, e nëse një gjë e tillë nuk mund të bëhet së shpejti, atëherë, në mënyrë që të ndërpritet praktika e diktimit, e cila është duke shkaktuar shumë vështirësi në procesin e mësimnxënies, do të ishte mirë të lejohej përdorimi i teksteve mësimore nga Bosnjë Hercegovina dhe Turqia, edhe përkundër faktit se ato nuk janë në përputhje me planprogramin e Ministrisë së Arsimit të Kosovës;
- do të ishte mirë që të zgjerohet hapësira e shkollave sepse në shumë shkolla ka shpërputhje frapante mes hapësirës dhe numrit të nxënësve, por do të ishte mirë edhe që të krijohen më shumë kabinete për lëndë shkencore;
- do të ishte mirë që të gjitha vendimet që afishohen në tabelën e njoftimeve në shkollë të jenë edhe në gjuhët e minoriteteve sepse ka nxënës që nuk e kuptojnë tërësisht përmbajtjen e tyre;
- do të ishte mirë që të mos ketë lëndë mësimore profesionale që jepen në gjuhën shqipe dhe nga profesorë shqiptarë sepse, sikundër u tha edhe më sipër, ka nxënës të minoriteteve që nuk e kuptojnë tërësisht gjuhën shqipe;
- do të ishte mirë që nxënësit e minoriteteve të mësojnë lëndën e gjuhës shqipe më shumë se dy herë në javë, meqë gjuha shqipe është gjuhë zyrtare, por edhe e kanë më lehtë për t’u shkolluar dhe për t’u punësuar;
- do të ishte mirë që në udhëheqësinë e shkollës të jetë një zëvendës-drejtor nga profesorët minoritarë, në mënyrë që komunikimi mes nxënësve minoritarë dhe drejtorisë së shkollës të jetë më i lehtë dhe më i shpeshtë;
- do të ishte mirë që mbledhjet obligative të prindërve të mos jenë katër herë në vit, por çdo muaj sepse kështu prindërit do të kishin më shumë mundësi për të diskutuar për problemet tjera, përveç komunikimit të suksesit në mësim, por edhe për arsye se kur nxënësit e dijnë që prindërit e tyre duhet të vijnë çdo muaj në shkollë, angazhohen më shumë ngase e dijnë që prindërit e tyre janë në ngjarje;
- do të ishte mirë që të rikthehej një herë në javë ora e kujdestarisë mes kujdestarit të klasës dhe nxënësve sepse kështu nxënësit do të mund t’i prezentonin ankesat, vërejtjet dhe shqetësimet e tyre;
- do të ishte mirë që në drejtoritë komunale për arsim të ketë përfaqësues të minoriteteve, në mënyrë që të prezentohen problemet e minoriteteve në fushën e arsimit;

- do të ishte mirë që të krijohej një zyrë në shkollë, ku do të punonte me orar të plotë një prind, i cili do të ishte në rrjedha vazhdimisht se çfarë po ndodhë në shkollë, cilat janë nevojat e nxënësve, dhe ku prindërit do të mund të vinin çdo ditë për të adresuar ankesat, shqetësimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre; po ashtu, do të ishte mirë që në shkollë të vendosej një kuti, por edhe të hapej një e-mail zyrtar, ku prindërit dhe nxënësit do të mund t'i dërgonin ankesat, shqetësimet, vërejtjet dhe sugjerimet e tyre;
- do të ishte mirë që një profesor, një prind dhe një nxënës nga radhët e minoriteteve të jenë anëtarë të Këshillit të Shkollës sepse kështu do të mund të përfaqësoheshin më mirë nevojat e tyre;
- do të ishte mirë që shkolla të ketë pedagogun, psikologun dhe mjekun e vet;
- do të ishte mirë që nxënësit e minoriteteve të kenë pushim për festat tyre nacionale;
- do të ishte mirë që në bibliotekat e shkollave ku ka minoritarë të ketë më shumë libra në gjuhët e minoriteteve që ka shkolla;
- do të ishte mirë që të bëhen projekte për kualifikimin e profesorëve minoritarë, por edhe që enkas për profesorët minoritarë të ketë trajnime për angazhimin e prindërve në procesin e edukimit, por edhe trajnime të natyrave tjera;
- duke e pasë parasysh që një pjese të prindërve të nxënësve të dobët u vjen keq të marrin pjesë në mbledhjet e prindërve, do të ishte mirë të ketë hapësira të veçanta për takime mes prindërve dhe kujdestarëve të klasës, në mënyrë që ata të informohen për suksesin/mos-suksesin e fëmijëve të tyre pa praninë e prindërve tjerë;

BIBLIOGRAFIA

1. Rregullorja nr 2002/19 lidhur me shpalljen e Ligjit mbi Arsimin Fillor dhe të Mesëm në Kosovë të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, 31 tetor 2002.
2. Udhëzimi Administrativ i Ministrisë së Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, 28 janar 2003.
3. Propozimi Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës, 26 mars 2007.
4. Ligji për Mbrojtjen dhe Promovimin e të Drejtave të Komuniteteve dhe Pesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, nr. 03/ L-047, 13 mars 2008.
5. Ligji për Arsimin në Komunitat e Republikës së Kosovës, nr. 03/ L-068, 21 maj 2008.
6. Kushtetuta e Republikës së Kosovës, 15 qershor 2008.